

Vëmendja
Referendumi,
temë kryesore
në Greqi

Fq.4



SHITBLERJA
Supermarkete
në vend të
dyqaneve
të mëhallës

Fq.5



I akuzuari
më fatlum
kroat për
krime lufte

Fq.18



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3473 · e hënë, 1 tetor 2018

15°C | 20°C

15 DEN

EDITORIAL

**Ujmani, skena
ku po maten
muskujt e
politikës**



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shkoi një hap përtej Vuçiqit. Ai u fut në ujërat e liqenit të Ujmanit, jo për të zënë peshq, por për të thënë homologut të tij serb se lundrimi në ujërat e Kosovës është sporti më i lirë që po shitet aktualisht në tregun e politikës. Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit arriti të mobilizojë një masë të madhe njerëzish për të dëshmuar se "populli është më i fuqishëm se individit"...

Fq.2

RAJON

**Vuçiq i kërkon
ndihmë
Putinit për
Kosovën**

Fq.16

GLOBI

**Trumpi:
Unë e Kim
Jong-uni
kemi rënë
në dashuri**

Fq.17



PAS REFERENDUMIT, ZAEVI I DREJTOHET VMRO-SË

VOTONI NDRYSHIMET, OSE SHKOJMË NË ZGJEDHJE



Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, edhe pse nuk u arrit censuri në referendum, votimin e djeshëm e shpalli fitore të vendit, ndërsa i apeloj VMRO-së që të mbështesin ndryshimet kushtetuese në Parlament. "I bëj thirrje VMRO-DPMNE-së që të mbështesin ndryshimet në Parlament, ose shkojmë në zgjedhje të parakohshme", tha Zaev. Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti, ndërkaq u shpreh se me votat e së dielës, qytetarët e deleguan votimin e ndryshimeve kushtetuese në duart e Parlamentit

Fq.3-4

Qytetarët do të lirohen nga "policët" përmbarues

Shkup, 30 shtator - Këtë javë, në seancën e parë plenare të Parlamentit të Maqedonisë, në rend dite do të gjendet edhe ligji për shlyerjen kamatave të borxheve të mbetura, që qytetarët e Maqedonisë i kanë ndaj kompanive private dhe shtetërore. Javë më parë Qeveria miratoi ndryshimet e Ligjit të noterëve dhe atij për përmbarim me të cilin përveç që do të shlyhen kamatat dhe qytetarët do të duhet të paguajnë vetëm

borxhin bazë, njëherazi do të ulen tarifat e noterëve dhe përmbaruesve. Ulja e shpenzimeve të qytetarëve të cilët kanë borxhe për shërbimet komunale dhe ata të cilët kanë kredi konsumatore, në të ardhmen do të jetë më të ulta. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, për shërbime noteriale, qytetarët do të paguajnë 10 për qind të borxhit të përgjithshëm, por jo më shumë se 500 denarë...

Fq.7



KOHA për sport

Fq.12-15

EDITORIAL

UJMANI, SKENA KU PO MATEN MUSKUJT E POLITIKËS



Emin AZEMI

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shkoi një hap përtej Vuçiqit. Ai u fut në ujërat e liqenit të Ujmanit, jo për të zënë peshq, por për ti thënë homologut të tij serb se lundrimi në ujërat e Kosovës është sporti më i lirë që po shitet aktualisht në tregun e politikës. Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit arriti të mobilizojë një masë të madhe njerëzish për të dëshmuar se "populli është më i fuqishëm se individi", mirëpo në Kosovë energjia politike po prodhohet edhe atëherë kur mbi Ujman po futen barkat e strategjisë së shpëtimit të moralit publik.

E ndarë në tre taborre, në ata që janë në pushtet, dhe në një opozitë dypjesëshe, Kosova po e vrapon pjesën e fundit të maratonës së ridefinimit të pozicionit të saj në hartën e re të Ballkanit. Në Prishtinë kundërshtarët e Hashim Thaçit ende nuk e kanë lexuar postën e diplomacisë së fshehtë, kurse në Beograd e Tiranë ende po presin të shpallosen edhe më tej qëndrimet e Uashingtonit e Brukselit.

Kosova e Serbia e kanë ndërmend të ndahen paqësisht, duke i lënë njëra tjetrës po aq territore sa do të mjaftonin për të përmbyllur lavditë politike me kompromise e jo me imponime. Në Prishtinë njerëzit me të drejtë druajnë nga tendecat e Beogradit për të përfituar pjesë të asaj që e kishin humbur në vitin 1999. Rikthimi i rajoneve serbe, sidomos në pjesët veriore të Mitrovicës, ku aktualisht adminstrata e Prishtinës nuk ka qasje të drejtpërdrejt, përbën një prej fijeve gati të padukshme të lëmshit të kompromiseve midis Kosovës e Serbisë. Në këtë lëmsh, gjithsesi futen edhe disa rajone të banuara me shqiptarë në Luginën e Preshevës, kurse pëlhuara që do të turrin nga ky lëmsh përbën befasinë më të madhe të shekullit. Kjo befasi nuk ka të bëjë vetëm me raportet Kosovë-Serbi, por edhe me një konstelacion më specifik gjeopolitik.

Ndërkohë, Gazeta prestigjioze amerikane Wall Street Journal, ka botuar një raport shumë konfidencial, për të cilin thotë se është baza e planit për korrigjimin e kufijve në mes Kosovës dhe Serbisë. Arsyeja e këtij plani, sipas memorandumit sekret të draftuar nga Shërbimi i Jashtëm i BE-së, është të "garantohet shtetësia e Kosovës".

Wall Street Journal shkruan se SHBA-ja dhe liderët e Bashkimit Evropian po bashkërendohen drejt mbështetjes së një plani në bazë të të cilit dy vendet e Ballkanit do të rishkruajnë kufijtë e tyre të përbashkët të tensionuar në baza etnike, duke përfshirë Gjermaninë, fuqinë më me ndikim të kontinentit të vjetër, e cila refuzon këtë qasje, thuhet në këtë dokument konfidencial.

Ndërsa marrëveshja thotë se Evropa dhe SHBA-ja vazhdojnë të punojnë bashkë për së afërmi në iniciativat e politikës së jashtme që prekin rajonin, çarja me Gjermaninë tregon po ashtu gatishmërinë e Uashingtonit për të injoruar kundërshtimet e fuqisë kryesore të kontinentit.

Në këtë dokument, Bashkimi Evropian e shfaq mbështetjen për një plan të përbashkët Kosovë-Serbi, i mbështetur nga administrata e presidentit Donald Trump, për t'i rishkruar kufijtë në Evropën Juglindore si mënyrë për të siguruar shtetësi të plotë për vendin e vogël dhe të bllokuar, Kosovën.

Nëse kjo dëshon, sipas këtij memorandum, vendi me 2 milionë banorë mund të hyjë në kriminalitet, konflikt e në ekstremizëm islamik. Javëve të fundit, sipas The Wall Street Journal, dy vendet kanë diskutuar një plan për të shkëmbyer territor për gjatë kufirit të tyre të përbashkët për të pasqyruar më mirë modelet e zgjidhjes së serbëve dhe shqiptarëve etnikë. Në Ujman do të lundrojnë edhe më tej barkat provuese të "peshkatarisë" ballkanike, kurse në Prishtinë e Beograd peshqit e politikës do të mundohen të adaptohen në ujërat e rrëmbyeshëm të ndryshimeve radikale.

MASAT ADEKUADE TË SIGURISË PËR VETËMBROJTJE

"Të urdhërosh ushtrinë që te vihet në gatishmëri luftarake për shkak se policia e Republikës së Kosovës dje me date 29 shtator paska kontrolluar një qendër sportive dhe humanitare në veri të vendit, përbën kërcënim klasik ushtarak për Kosovën por edhe për rajonin.

Një ngritje të tillë të gatishmërisë luftarake mund ta japin vetëm elita ekzistuese politike serbe, e kamufluar me petkun e integritit në BE. Këto veprime lënë të kuptohet se Serbia vazhdon të konsideron një pjesë të Kosovës, përkatësisht veriun e saj si pjesë përbërëse të saj dhe vepron në çdo formë për të demonstruar kontrollin e saj. S'do mend se një qasje e tillë e Serbisë zyrtare në momentin aktual është me teper se destabilizim.

Për këtë, vëmendja e jonë duhet të jetë e përqendruar në ndërmarrjen e masave adekuate të sigurisë për vetëmbrojtje. Nisma e krijimit të ushtrisë së Kosovës në fund të vitit dhe krijimi i kapaciteteve defanzive të mbrojtjes janë në këtë frymë", ka një shkruar një status në Facebook, gjenerali në pension Ramadan Qehaja.



PËR ATA QË E KRITIKOJNË APO E SHAJNË THAÇIN

"Një numër i madh i atyre që e kritikojnë apo e shajnë Hashim Thaçin e kanë në baza personale. Fjala është për disa gazetarë, analistë dhe tjerë me lloj-lloj profesione. Këta janë hidhëruar për shkak se Thaçi nuk i ka marrë në shërbim. Disa tjerë janë hidhëruar se i ka përfshirë nga shërbimi. Të merremi vesh, këtu nuk kemi të bëjmë me parime. Këta nuk e kanë dertin e demokracisë. Këta hallin e kanë të pushteti i cili ju sjell pasuri dhe popullaritet. Këta janë kockarë dhe Kosovën e shohin dhe e dojnë si xhanarrin kur luajnë me letra (bixhoz)", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Daut Dauti.



ALBANOLOGJIA POSTMODERNE

"Filologët - flasin për letërsinë, rrëmuesit nëpër qilarët e dosjeve - bëhen akademik, letrarët - shkruajnë historinë, arkeologët - këndojnë poezi, ekspertët e historisë - shkruajnë parathënie për opinionistët... Kjo është pamja e albanologjisë zyrtare...", ka shkruar një status në Facebook, studiuesi nga Tirana, Behar Gjoka.



MEDIA Citate

USHTARAKËT SHQIPTARË CERTIFIKOHEN NGA NATO

Forcat e Armatosura të Shqipërisë pas përfundimit të stërvitjes ushtarake kanë pjesë të tyre një grup batalion të vlerësuar sipas standardeve të NATO-s. Në fund të stërvitjes njëjavore "Albanian Lion/Biza 18", ku morën pjesë mbi 1 mijë e 200 trupa e mjete ushtarake, Grup- Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) u certifikua si "Combat Ready" (I gatshëm për luftë), nën monitorimin e ekspertëve të NATO-s, thuhet në njoftimin nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë.

Ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, në fjalën e saj në ceremoninë për përfundimin e stërvitjes tha se Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë shënuar një pikë kthese në historinë e tyre, duke u renditur të barabartë me të barabartëve. "Certifikimi, nga ana e NATO-s, i Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë dhe deklarimi i tij, Combat Ready (I gatshëm për luftë) shënon përbushjen e pjesës më të rëndësishme të detyrave tona të shtëpisë, detyrimeve të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të vendit tonë ndaj Aleancës. Ndaj pa frikë mund ta quajmë këtë hop cilësor, një eveniment historik në marrëdhëniet tona me NATO-n", theksoi ministrja Xhaçka në ceremoninë e organizuar në zonën e Bizës.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, Grup- Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë gjatë stërvitjes certifikuese "Albanian Lion/Biza 18" u angazhua në një sërë skenarësh, të përgatitur mbi praktikë me të mira të vendeve të NATO-s, duke testuar kapacitetet operacionale që ata zotërojnë, por edhe për aftësitë e tyre profesionale në fushën e luftimit. Për disa ditë me radhë në Shqipëri, në disa zona të vendit u organizua edhe stërvitja ushtarake "Albanian Lion 2018" me pjesëmarrjen e Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Britanisë, Kosovës dhe Kroacisë.

(Anadolu Agency, 30 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

MBRETËRESHA PËRSHËNDET ME DORË FALSE

Mbretëresha Elisabeth e Britanisë së Madhe është pa dyshim mbretëresha e rekordeve. Mbretëresha ka 66 vjet në fron, duke thyer kështu një tjetër rekord të vetin. Ajo është gjithashtu mbretëresha me moshën më të madhe në fron, 92 vjeçe. Përhëndetja me dorë është një nga gjestet që nuk mungon asnjëherë në çdo dalje publike të saj. Një lëvizje kjo që tani është bërë pothuajse një traditë për çdo brez dhe në këtë gjest e kemi parë edhe tek fëmijët e vegjël të princ William, George dhe Charlotte. Por kohët e fundit mbretëresha na paska fshehur diçka, ajo përdor një dorë false për të përshëndetur. Zbulimi është bërë nga vajza e saj, princesha Anna, e cila në intervistën për Robert Hardman, autorin e librit biografik



"Queen Of The World", ka treguar për këtë sekret të vogël të mbretëreshës. "Aktivizohet një levë dhe kështu dora lëviz nga një anë në tjetrën. Kur mbretëresha ka pak nevojë të çlodhet, ajo përdor këtë armë sekrete", ka shpjeguar princesha, Anna. Sipas saj, dora false është një dhuratë nga disa student australianë.



19 incidente të vogla gjatë votimit

Shkup, 30 shtator - Ministria e Punëve të Brendshme informoi se gjatë ditës së referendumit janë regjistruar 13 incidente. Pas denoncimit të marrë nga Komisioni komunal zgjedhor se në shkollën fillore "Koço Racin" në Shkup një vajzë e cila ka votuar me stilolaps në të cilin ka pasur kamerë, e ka fotografuar fletëvotimin ose të pranishmit në hapësirë, nëpunësit policorë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe merren masa për zbardhjen e rastit.

Pas denoncimit të marrë se në rrethinën e shkollës fillore "Pestaloci" në Shkup janë penguar qytetarët të cilët shkonin në votim dhe janë fotografuar, nëpunësit policorë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe pas masave të marra është konfirmuar se bëhet fjalë për personin S.Ç. (28) nga Shkupi. Ajo është arrestuar në Stacionin policor Qendër për procedurë të mëtejshme.

Sipas MPB-së, pas denoncimit të marrë se në vendvotimin nr. 2664 në shkollën fillore "Kuzman Josifovski" në Shkup në orën 13:05 një person i panjohur ka fotografuar fletën e një personi tjetër, pas çka e ka braktisur vendvotimin. Janë marrë aktivitete dhe masa dhe në Stacionin policor Kisela Vodë janë thirr personat I.T. (28) dhe Gj.C. (63), të dy nga Shkupi. Në orën 12:45 është denoncuar se në vendvotimin nr.2436 në f. Gërçev është ndërprerë votimi në periudhën nga ora 12:25 deri në orën 13:13 për shkak të mungesës së fletëvotimeve nga blloku.

Në vendvotimin nr.399 nga shkolla fillore "Ismail Qemali" në Gostivar është denoncuar se A.M. (72) nga Gostivari, pas realizimit të të drejtës së votimit, e ka shqyer fletëvotimin pas çka ka kërkuar një fletëvotim tjetër. Personi është arrestuar në Stacionin policor Gostivar për zbardhjen e rastit.

Në vendvotimin nr. 2447 në fshatin Laskarcë, I.P anëtar i organizatës joqeveritare ka denoncuar se është maltretuar dhe ka marrë kërcënime nga anëtarët e këshillit zgjedhor. Merren masa për zbardhjen e rastit.

(O.XH)

PAS REFERENDUMIT, ZAEVI I DREJTOHET VMRO-SË

VOTONI NDRYSHIMET, OSE SHKOJMË NË ZGJEDHJE

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, edhe pse nuk u arrit censusi në referendum, votimin e djeshëm e shpalli fitore të vendit, ndërsa i apeloj VMRO-së që të mbështesin ndryshimet kushtetuese në Parlament. "I bëj thirrje VMRO-DPMNE-së që të mbështesin ndryshimet në Parlament, ose shkojmë në zgjedhje të parakohshme", tha Zaev. Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti, ndërkaq u shpreh se me votat e së dielës, qytetarët e deleguan votimin e ndryshimeve kushtetuese në duart e Parlamentit

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 30 shtator - Kryeministri Zoran Zaev, edhe përkundër mos arritjes së censurit prej 51 për qind të referendumit për emrin, tha se vota pro në referendum duhet të lexohet qartë nga deputetët e VMRO-DPMNE-së për të votuar në Parlament. Në të kundërtën, Zaev tha se do të duhet ti kthejnë sytë nga mjete tjetër demokratik - zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

"Të nderuar qytetarë, unë do të vazhdoj të udhëheq, Maqedonia do të jetë anëtar e NATO-s dhe e BE-së", kjo ishte fjalja e fundit e kryeministrit Zaev gjatë konferencës për shtyp pas orës 19. Ai tha se interesi shtetëror është i të gjitha bashkësive etnike pavarësi-



XHAFERI NUK VOTOI, NUK ISHTE NË LISTË



Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, nuk ka mundur të realizojë të drejtën e tij të votës. Kjo i është pamundësuar nga Lista e zgjedhësve në vendvotimin e tij në fshatin Forinë, ku nga arsye të panjohura, emri i njeriut të parë të Parlamentit është hequr nga Lista e votuesve. Është interesante se në të gjitha ciklet zgjedhore, Talat Xhaferi ka votuar në fshatin e tij të lindjes në Forinë. Përveç kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë, sipas disa vëzhguesve, sot të drejtën e votës nuk kanë arritur ta realizojnë edhe qindra qytetarë tjerë, të cilët nga shkaqe të panjohura nuk kanë gjetur vetën në listat e votuesve.

sht, bojkotit të VMRO-së.

"Qytetarët dhe institucionet sot ishin të qetë. Qytetarët sot treguan se janë pjesë e familjes së madhe evropiane. Qytetarët votuan të pavarur dhe të lirë. Referendumi ishte mjeti më i mirë demokratik ia tyre që dolën të votojnë. Shumica e qytetarëve që votuan, hapën rrugën për në Bashkim Evropian dhe në NATO", tha Zaev, duke shtuar se vullneti i qytetarëve që votuan në këtë referendum konsultativ, duhet të shprehet më tej në shtëpinë legislative.

"Vota e qytetarëve në masë të madhe është pro dhe vota e depu-

tetëve duhet të jetë votë me përgjegjësi për të çuar përpara proceset integruese", tha mes tjera sh kryeministri.

VENDIMMARRJA NË DUART E PARLAMENTIT

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti ndërkohë ka uruar qytetarët e Maqedonisë, institucionet e vendit, të gjitha partitë politike të cilat kontribuuan në mbarëvajtjen e procesit të referendumit për shfaqjen e qytetarisë dhe kulturës demokratike.

"Sot, ne demonstruam kapacitete demokratike të denja për një vend pretendent për integrim në



Menduh Thaçi

Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi, së bashku me familjen e tij votoi në vendvotimin në kopshtin e vjetër "Rinia" në Tetovë. "Besoj se do të kemi ditë të qetë pa kurrfarë problemesh dhe gjithashtu besoj se do të kemi përgjigje masive prej qytetarëve të Maqedonisë për referendumin", deklaroi lideri i PDSH-së, Thaçi pas votimit.

NATO dhe në BE.

Ky proces i reformave, barazisë dhe mbylljes së çështjeve me fqinj të tanë garanton paqe të qëndrueshme, siguri, stabilitet, marrëdhënie të mira ndërfqinjësore dhe ndëretnike, zhvillim ekonomik, më shumë vende pune, investime vendore dhe të huaja si dhe mirëqenie shoqërore. Unë dhe Bashkimi Demokratik për Integrim që në fillim e kemi thënë që vendimmarrja i takon institucioneve të vendit të zgjedhura në mënyrë legjitime dhe me kapacitet të plotë vendim-marrës", ka thënë Ahmeti.

Sot, ka vijuar më tej ai, qytetarët e vendit ia deleguan vendimmarrjen Parlamentit të Maqedonisë dhe deputetëve të zgjedhur në zgjedhje legjitime dhe demokratike.

SELA: TË VENDOSIM PËR ARDHMËRINË

Kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, në vendvotimin në SHFK "Aki Dika" në Livadhi e realizoi të drejtën e tij të votimit në referendumin e djeshëm. "Si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, edhe unë dola dhe votova këtu në vendlindjen time. Apeli im është që qytetari të dalë të vendosë sot për fatin e tyre. Është shumë e rëndësishme. Kjo është demokraci direkte referendum, ku ata vetëvendosin për ardhmërinë e tyre", deklaroi Sela. Ai u bëri thirrje qytetarëve që të dalin sa më tepër në numër dhe të votojnë, të shprehin verdiktin e tyre. "Duhet të dalin



dhe të shprehin vullnetin e tyre. Kjo ditë është e rëndësishme për vetë faktin që njëherë e përgjithmonë do të bëhet shkëputja e një të vjete nga e vjetra dhe do të nisim nga fillimi, prandaj e shohë të rëndësishme. NATO dhe BE-ja më tepër është demokraci, më tepër liri, më tepër mendim i lirë, shohë më pak procese të montuara politike, më pak drejtësi me dy standarde, më shumë drejtësi për të gjithë, më tepër zhvillim ekonomik, më tepër vende të reja pune", theksoi lideri Sela.



(vijon nga fq.3) "Ne jemi të zgjedhur që të marrim vendime të rëndësishme, vendime të guximshme, e jo të kalkulojmë për zgjedhjet e ardhshme dhe mandatin e ardhshëm. Me votën tonë në Parlament, ne e përcaktojmë të ardhmen e vendit tonë, të ardhmen e gjeneratave që vijnë pas nesh, por edhe të ardhmen e rajonit të Evropës Juglindore. Në zgjedhjet e vitit 2016, ne u zotovam për barazi, integrim euroatlantik, reforma të thella sistemore, shtet ligjor dhe sundim të së drejtës si dhe zhvillim ekonomik", është shprehur Ahmeti. Gati se të njëjtat premtime, ka shtuar Ahmeti, i dhanë edhe të gjitha partitë tjera parlamentare dhe bashkë u mandatuam për realizim të këtyre premtimeve të dhëna para qytetarëve.

"Prandaj, kjo përbërje e Kuvendit ka mandat për zgjidhje të çështjeve me fqinjët dhe integrim të vendit në NATO dhe në Bashkimin Evropian dhe me vendimin e tyre, sot qytetarët e deleguan të drejtën e vendimmarrjes tek deputetët dhe institucionet e vendit. Maqedonia alternativë tjetër nuk ka përveç se integrimin në NATO dhe në Bashkimin Evropian".

REFERENDUMI, TEMË KRYESORE NË GREQI

Cikloni "Zorbas" është lajmi i parë, ndërsa referendumi në Maqedoni ishte lajmi i dytë më i rëndësishëm në mediat greke. Në edicionet e gazetave të së dielës, të portaleve informative, në emisionet politike të radiove, në lajmet, në emisionet informative dhe debative të televizioneve greke, votimi të ne, menjëherë pas motit të keq, e monopolizoi vëmendjen e opinionit grek.

Një numër i madh i mediave greke kanë dërguar gazetarë në Shkup, të cilët nga e premtja raportojnë për klimën në Maqedoni, për analizat dhe vlerësimet, por edhe për rëndësinë e referendumi të sotëm. Në televizionet greke ka raportime të drejtpërdrejta nga kryeqyteti i Maqedonisë.

Gazetarët grekë përveç se raportojnë për informacionet kryesore dhe të dhënat në lidhje me referendumin, në lidhje me atë se sa qytetarë kanë të drejtë vote, se kur hapen dhe kur mbyllen vend-

votimet, se kur do të bëhen të ditura rezultatet e para nga KSHZ-ja dhe ngjashëm, komentojnë se ajo që është më rëndësishme, nuk është se shumica a do të votojë "për" ose "kundër", por se a do të ketë dalje. Referendumi dhe rezultatet në Greqi, drejtpërdrejtë, janë të lidhura edhe me skenën politike në vend, duke e pasur parasysh se topi dalëngadalë do të gjuhet në terrenin grek.


Analizat në Greqi janë rreth skenarëve për mbijetesën e Qeverisë greke, gjegjësisht se cilat do të ishin hapat e ardhshëm të partnerit të koalicionit Panos Kameanos, i cili është kundër Marrëveshjes së Prespës dhe në muajt e kaluar doli me deklarata të ndryshme, me kërkesë që të votohet me shumicë të rritur parlamentare, e deri te qëndrimi i fundit se Grekët e Pavarur do të tërhiqen nga qeveria. Por, po analizohen edhe hapat e ardhshëm të Demokracisë së Re opozitare, e cila nuk heq dorë nga qëndrimi se marrëveshja është e dëmshme për Greqinë. Mediat nuk e përjashtojnë mundësinë, që partia më e madhe opozitare të dorëzojë iniciativë të re për votim të mosbesimit të qeverisë, duke e pasur parasysh se nga mesi i dhjetorit do të kalojnë gjashtë muaj nga iniciativa e fun-

dit me çka rishtazi do të kenë të drejtë të kërkojë votim për mosbesim.

"MAQEDONIA BOJKOTON" FESTOI PARA PARLAMENTIT

Bojkotuesit e Referendumi për ndryshimin e emrit të Maqedonisë dhe anëtarësimin saj në strukturat e euroatlantike, të dielën mbrëma kanë festuar para godinës së Parlamentit në Shkup. Festa e tyre për dështimin e Referendumi ka filluar që në orën 19:00, sapo është përmbyllur procesi votues. Gjatë fushatës 20 ditore "Bojkotuesit e Referendumi", në krye me kryetarin e tyre Janko Baçev, në vazhdimësi kanë agjitur se pala maqedonase nuk duhet të pranojë një marrëveshje poshtëruese me shtetin grek. Njëkohësisht, në konferencat e tyre për shtyp ato vazhdimisht i kanë shprehur qëndrimet e tyre se shteti i Maqedonisë duhet të orientohet drejtë përforsimit të raporteve me Federatën Ruse. Përkrah Baçevit, nën moton "Maqedonia Bojkoton", gjatë javëve të kaluara janë rreshtuar edhe disa organizata joqeveritare, aktivistë dhe funksionarë të VMRO-DPMNE-së, të cilët nuk ishin të kënaqur nga zgjedhja e Kristian Mickovskit në krye të kësaj partie.

JEHONA E VOTUESVE NË ZGJEDHJE DHE REFERENDUME NË MAQEDONI



Kasami: Votohet për të ardhmen

Kryetari i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami, ka votuar në qytetin e Tetovës, ku nga aty dha mesazh se ky referendum ka të bëjë me ardhmërinë e vendit dhe brezave që do të lëmë pas nesh. Kasami gjithashtu theksoi se qytetarët e kanë fatin në duart e tyre dhe ata duhet të vendosin për ardhmërinë e vet, duke votuar "PËR" në këtë referendum. "Ndryshe nga zgjedhjet e tjera nuk votohet për deputet apo për kryetar komunash, por sot votohet për të ardhmen e vendit dhe fëmijëve tanë", u shpreh para mediave lideri i BESËS, Bilall Kasami.



Osmani: Ditë që vendoset ardhmëria



Në jetën time nuk kam pasur ditë në të cilën kam sjellë vendim më të madh dhe më të rëndësishëm për fëmijët e mi, për familjen time, por edhe për të gjithë qytetarët. Edhe në jetën private edhe në jetën zyrtare. Këtë sot e deklaroi zëvendëskryeministri i Çështjeve Evropiane Bujar Osmani pasi votoi në referendum në vendvotimin SHF "Adem Jashari" në Komunën e Çairit. "Ditë më të rëndësishme për vendim më të rëndësishëm nuk kam pasur as unë, mendoj as gjenerata ime nuk ka pasur ditë më të rëndësishme. Ditë që vendoset ardhmëria në kontrastet më të fuqishme të vendimit, jo në nuancat më pak të mira apo më pak të këqija. Por pikërisht sot i caktojme orientimet e shtetit, të ardhmërisë", tha Osmani. Sipas tij, qytetarët janë të vetëdijshëm për vendimin që e sjellin dhe sot në mënyrë masive do të dalin prej të gjitha bashkësive etnike dhe prej të gjitha gjeneratave.

Dimitrov: Sot populli flet

Fuqishëm agoi dita e sotme. Më shumë se një muaj politika foli dhe shpjegoi se sa i madh është investimi historik në këtë udhëkryq të sotëm. Sot populli flet, kurse populli flet përmes votimit, tha ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov pasi votoi në referendum në vendvotimin tek Qendra Kulturore "Koço Racin" në Shkup. "Shpresoj se sot do të jetë ditë feste për demokracinë dhe se përfundimisht Maqedonia do të ecë para dhe në drejtimin e duhur - drejtë BE-së dhe NATO-s duke e ruajtur atë të rëndësishmen për ne", shtoi Dimitrov. Në deklaratë për shumicën e mediave të rajonit shefi i diplomacisë së Maqedonisë tha se dita e sotme është e rëndësishme edhe për miqësinë me fqinjët e rajonit.



Shekerinska: Tani është koha të themi PO

Pres që referendumi të jetë njëjtë sikurse dita e sotme, plotë besim, shpresë dhe dashuri, plotë besim se mund të jemi shtet më i mirë, shpresë se atë po e bëjmë me veprimin tonë të sotëm me shumë, shumë dashuri ndaj Maqedonisë tonë, tha zëvendëskryeministria dhe ministere e Mbrojtjes, Radmila Shekerinska pas votimit në referendum në Shkollën e Mesme "Gjeorgji Dimitrov" në Shkup. Ajo tha se pret një proces ku shumica e qytetarëve fuqishëm do të tregojë se tani është koha që Maqedonia të bëhet anëtare e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian dhe se me atë përkrahje të fuqishme me të vërtetë mund të bëjmë mrekulli.



NDRYSHOHEN SHPREHITË E BLERJES

SUPERMARKETE NË VEND TË DYQANEVE TË MËHALLËS



Analiza e të dhënave statistikore tregon se në harkun kohor 2003-2016 janë mbyllur mbi 6000 dyqane, ndërsa nga ana tjetër janë hapur me dhjetëra markete të tregtarëve nga jashtë shteti, por edhe nga tregtarët vendor të shitjes me pakicë

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 30 shtator - Maqedonia ngadalë por sigurt po ndjek trendet globale të uljes së punës së dyqaneve të vogla të mëhallës në raport me rrjetet e ndryshme të supermarketeve.

Uljen e punës së shitoreve të vogla e konfirmojnë edhe të dhënat e Entit të Statistikës, apo "Regjistri i tregtisë me pakicë", sipas të cilit në vitin 2003 në shtet kanë punuar 24.276 dyqane të ndryshme, ndërsa në vitin 2016 apo 13 vite më vonë numri i tyre është zvogëluar në 18.250. Në këtë total me gati një të katërtën dominojnë dyqanet ushqimore. Analiza e të dhënave statistikore tregon se në harkun kohor 2003-2016 janë mbyllur mbi 6000 dyqane, ndërsa nga ana tjetër janë hapur me dhjetëra e dhjetëra markete të investitorëve të huaj, por edhe nga tregtarët vendor të shitjes me pakicë. Në ndërkohë, rrjeti i parë modern i supermarketeve në Maqedoni daton nga viti 1994 dhe ndërlihet me kompaninë vendore të tregtisë me pakicë, Tineks. Sot

ai ka 39 dyqane dhe supermarkete në tërë Maqedoninë.

Supermarketet Vero që para 21 vitesh ishin investimi i parë i huaj në rrjetin e tregtisë me pakicë në Maqedoni. Ky rrjet me origjinë nga Greqia ka hapur 12 supermarkete në Shkup dhe qytetet e tjera më të mëdha në Maqedoni.

Ramstore filloi me punë më vitin 2005 në Shkup me hapjen e supermarketit të parë, për të zgjeruar më vonë rrjetin e shitjes, jo vetëm në kryeqendrën e Maqedonisë, por edhe në qytetet më të mëdha në shtet. Ai ofron shërbimet e tij në shtatë qytete të ndryshme të vendit në 26 markete më të vogla dhe supermarkete.

Njëherësh në vitet e fundit në Maqedoni një bum të madh të hapjes së marketeve më të vegjël shënojnë edhe shumë kompani vendore. Kipper, KAM Market, Stokomak, Zhito Marketi etj. janë disa nga brendet vendore që seriozisht me ofertën e tyre dhe shtrirjen në tërë Maqedoninë ju konkurrojnë supermarketeve Tineks, Vero dhe Ramstor.

Gjithashtu të dhënat tregojnë se sipas qarkullimit disa nga rrjetet vendore të tregtisë me pakicë bile renditen edhe para kompanive të huaja të tregtisë me pakicë. Në vitin 2015, kompania Kam ka pasur qarkullim prej afër 94 milionë euro dhe fitim prej afër 4 milionë euro, e pasuar nga Tineksi me 91 milionë euro xhiro dhe fitim prej afër 3.7 milionë euro dhe Zhito Marketi me qarkullim prej afër 42 milionë euro dhe fitim prej 1.1 milion euro. Në vendin e katërt, sipas treguesve financiar ka qenë Ramstor me qarkullim prej afër 36 milion euro dhe fitim prej afër 400 mijë euro, i pasuar nga Stokomak me 29 milionë euro qarkullim dhe fitim prej afër 1.3 milion euro.

Në vendin e gjashtë të renditjes është kompania Kiper me qarkullim prej afër 22 milionë euro dhe fitim prej afër 1.1 milion euro, e pasuar nga "Skopski Pazar", me qarkullim prej afër 17 milionë euro dhe fitim prej 570 mijë euro. 20 kompanitë e tjera në renditje qarkullojnë prej 6 deri në 14 milionë euro në vit dhe kanë fitim prej 600 deri 800 mijë euro.

Ulet çmimi i energjisë elektrike

Shkup, 30 shtator - Në gjysmën e parë të këtij vitit çmimi mesatar me pakicë i energjisë elektrike për amvisëri ka arritur 4.773 denarë për kilovat orë dhe shënon ulje prej katër për qind në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2017, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Çmimi mesatar i energjisë elektrike pa tatum të vlerës së shtuar për konsumatorët përfundimtarë, përveç amvisërive, lëviz prej 3355 deri 7603 denarë për kWh sipas grupeve të konsumatorëve. Çmimi mesatar i gazit natyror pa tatum të vlerës së shtuar për konsumatorët përfundimtarë, përveç amvisërive, lëviz prej 16.269 deri 20.616 denarë për metër kub normal (nm3) sipas grupe të konsumatorëve. Çmimi mesatar me pakicë i gazit natyror për amvisëritë ka arritur 33.247 denarë për nm3.

Motoçiklistët, pjesë e përditshme e aksidenteve rrugore

Shkup, 30 shtator - Kultura e qytetarëve në komunikacionin rrugor vazhdon të mbetet çështje e hapur. Përkundër apeleve dhe fushatave të sektorit civil dhe institucioneve shtetërore, në Shkup po edhe më gjerë gati për çdo ditë regjistrohen aksidente komunikacioni, ku pjesëmarrës janë drejtuesit e motoçiklistëve. Mungesa e helmetës mbrojtëse dhe shpejtësia e pakontrolluar paraqesin vërejtjet më të shpeshta të cilat i japin nga policia rrugore, por edhe në përgjithësi opinionin. Një rast i tillë ku një shofer

motori u lëndua u regjistrua të shtunën në qendër të Shkupit. "Ngjarja ka ndodhur në udhëkryqin mes rrugëve 'Dimitrie Cupovski' dhe 'Mito Haxhivasilev Jasmin'. Banori i Shkupit, N.K., 39 vjeçar, duke drejtuar motoçikletën e tij 'Kimiko Aigiliti' e ka humbur kontrollin dhe ka rënë në asfalt", njoftojnë nga policia e Shkupit. Mes tjerash, nga ky sektori i policisë theksojnë se personi në fjalë menjëherë është transferuar në Qendrën Klinike "Nëna Terezë" ku dhe janë konstatuar lëndime të rënda trupore. (O.Xh)

KRONIKË

Tre zjarre në tre vende të ndryshme

Të shtunën brenda 9 orëve në tre lokacione të ndryshme në Tetovë janë përhapur tre zjarre në vende të hapura. Në një sipërfaqe më të madhe është djegur kullosë e thatë, në atarin e fshatit Grupçin, në vendin e quajtur "Lug", më pas në dalje të fshatit Prelubishtë, nga të dyja anët në rrugën regjionale Zhelinë-Jegunoc dhe për rreth rrugës së vjetër për në fshatin Bërvenicë. Me intervenim të zjarrfikësve të Tetovës, të tre zjarret janë lokalizuar në kohë, dhe nuk është bërë ndonjë dëm i dukshëm. Për shkak të kësaj, si dhe për shkak të lëvizjeve të shpeshtuara nëpër malet përreth në rajon, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë përsëri apelon deri të bujqit dhe të gjithë individët tjerë, të cilët për shkaqe dhe nevoja të ndryshme, lëvizin nëpër fusha ose male, të kenë kujdes gjatë ndezjes së zjarreve, dhe të mos hedhin shpuza cigaresh të ndezura, dhe djegurina të pa shuara mirë. Kjo njëkohësisht ka të bëjë edhe me shëtitësit në piknik, drupreresit, barinjët e kështu me radhë, të cilët punojnë dhe qëndrojnë në pyje, për arsye se mjafton edhe një shkëndijë e vogël, që të kaplojë një stuhi zjarri, me përmasa të mëdha dhe me dëme dhe pasoja të paparashikuara. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë edhe njëherë rikujton se shkaktimi i zjarreve, me qëllim apo nga pakujdesia, paraqet vepër penale, për të cilën parashihet edhe dënim me burg disaveçarë.

Shtatë kundërvajtje për përparësi kalimi

Në zonën më të gjerë të Pollogut, gjatë këtij vikendi është realizuar kontroll aksion për mos respektimin e përparësisë së kalimit, si një nga shkaqet kryesore, në aksidentet e trafikut gjatë këtij viti. Gjatë aktivitetëve në Tetovë, janë zbuluar 16 kundërvajtje të cilat janë sanksionuar në mënyrë ligjore me 6 fletëpagesa për kundërvajtje, dhe 9 fletëpagesa të detyrueshme për kundërvajtje, derisa gjatë kontrollit në Gostivar, është konstatuar vetëm një kundërvajtje e këtille, si dhe 4 kundërvajtje të llojeve të ndryshme.

Zjarrfikësit me punë të shtuar për vikend

Në rrethinë e Shkupit, gjatë vikendit të kaluar janë regjistruar disa zjarre. Raportet ditore të Ministrisë për Punë të Brendshme thonë se rasti i shpërndarjes së zjarrit ka ndodhur në zonën industriale "Bunarxhik", më konkretisht në rrethinë "TIRZ 2". Njësitë zjarrfikëse pas daljes në terren kanë konstatuar se zjarri ka ndodhur si pasojë e barit të thatë, në afërsi të të cilave ka pasur edhe vreshta. Ndërhurja e shpejtë e ekupeve të zjarrfikësve ka rezultuar që rreth orës 23:00, të datës 29 shtator zjarri të lokalizohet. Ndryshe, nga shkaqe ende të panjohur të shtunën, në Shkup është djegur edhe një magazinë private, pronë e personit S.I. Megjithatë, zjarri më rëndë i regjistruar së fundmi ka ndodhur në fshatin Vërtakicë, rrethinë e Shkupit, ku banorin Rufat Memeti i është djegur stani me disa bagëti. Duke folur për këtë ndodhi tragjike, Memeti për TV SHENJA ka thënë se vit pas viti, ai dhe familja e tij pësojnë dëme të ndryshme nga vënia e qëllimshme e zjarreve në pronat tyre. (U.H)

LIGJI PËR TRANSPORTIN E FËMIJËVE NË MAKINË

ULËSET E POSAÇME, DETYRIM PËR PRINDËRIT

Shumë prindër janë të bindur se askush nuk mund ta mbrojë më mirë të porsalindurin e tyre përpos tyre, mirëpo të gjitha studimet vërtetuan se në rast aksidenti, është pothuajse e pamundur ta mbani fëmijën e në kraharorin e tyre



prindërve të tyre.

Në bazë të statistikave zyrtare nga Ministria për Punë të Brendshme, që nga viti 2015, pra nga koha kur ky detyrim është i detyrueshëm, janë shqiptuar vetëm 39 dënime në të gjithë vendin. Dënimi është 35 euro dhe 15 pikë negative. Në të njëjtën kohë statistika e vdekshmërisë së fëmijëve në aksidentet e trafikut janë të mëdha.

LIGJ QË ZVOGËLON RREZIKUN E VDEKJES

Shumë prindër janë të bindur se askush nuk mund ta mbrojë më

mirë të porsalindurin e tyre përpos tyre, mirëpo të gjitha studimet vërtetuan se në rast aksidenti, është pothuajse e pamundur ta mbani fëmijën e në kraharorin e tyre. Testimet po ashtu treguan se edhe po të arrijnë prindërit që t'i mbajnë fëmijët e tyre në kraharor, shpesh herë e shtrëngojnë atë duke shkakuar lëndime të ndryshme.

Statistikat e aksidenteve të trafikut në Maqedoni nuk janë optimiste. Sipas të dhënave, fëmijët shpesh janë pjesë e aksidenteve të trafikut. Shifrat nga Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunikacio-

nin Rrugor tregojnë se në vitin 2015 kur edhe hyri në fuqi ky ligj, nga 148 persona të cilët humbën jetën në aksident, 22 prej tyre kanë qenë fëmijë deri në moshën 18 vjeçare dhe 9 prej tyre ishin deri në moshën 4 vjeçare. Ndërkaq në bazë të statistikave në gjysmën e parë të vitit 2018 janë shkruar gjithsej 4 gjoba për shkak të mosrespektimit të rregullave ligjore për vendosjen e një karrige fëmijësh në makinën e tyre. Ndërsa nga viti 2015 janë shqiptuar gjithsej 39 dënime. Autoritetet kanë shqiptuar gjoba më shumë në vitin 2017, ku u shqiptuan gjithsej 19

gjoba, ndërkaq ky numër në vitin 2016 ishte 14. Më pak vepra për thyerjen e kësaj rregulle ka në vitin 2015 kur dhe Ligji hyri në fuqi. Përndryshe, përdorimi i ulëseve të fëmijëve zvogëlon vdekjen e fëmijëve me 50 për qind, dhe tek foshnje deri në 70 për qind.

RREGULLAT PËR TRANSPORTIN E FËMIJËVE

Ligji për sigurinë në trafikun rruqor rregullon, rregullat për transportin e fëmijëve në anën e pasme dhe të përparme të ulëseve në automobil, gjithashtu parashikon gjoba të veçanta nëse këto rregulla nuk respektohen. Në një makinë për pasagjerë në pjesën e pasme, mund të lidhet fëmijë më i vogël se 5 vjeç në karrigen për fëmijë e cila është e lidhur me anë të rripit të sigurimit ose në ndonjë mënyrë tjetër për ulësen e automobilin. Në ulësen e përparme mund të lidhet fëmijë deri në moshë 2 vjeçare, në qoftë se automjeti nuk ka airbag mbrojtës, nëse airbag është i mbyllur dhe nëse fëmija lidhet në karrige të veçantë për fëmijë të vendosur në drejtim të kundërt të lëvizjes, me ç'rast është e lidhur me ulësen e automjetit me ndihmën e rripit për siguri- m në tre pika për lidhje.

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 30 shtator - Ulja e fëmijëve në karrigen për fëmijë në automobila është angazhim i detyrueshëm për tre vite me radhë, ndonëse prindërit ngadalë e pranojnë praktikën e lidhjes së fëmijëve gjatë ngasjes së tyre. Në vendet e zhvilluara, ky detyrim respektohet në mënyrë të vazhdueshme, por në vendin tonë, pavarësisht nga fakti që vepra është e dënueshme, fëmijët shpesh mbahen në duart e

Përpara ka qenë e domosdoshme përdorimi i injeksioneve, ndërsa tani kultura e përgjithshme shëndetësore është rritur edhe te prindërit, sidomos për fëmijët ku terapia e injeksioneve po zëvendësohet me terapi të tjera

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 30 shtator - Injeksioni ishte ilaçi i parë të cilin e ofronte mjeku, por në shumicën e rasteve e kërkonte edhe pacienti duke shpresuar në efikasitetin më të madh për shërimin e sëmundjes që kishin. Por, teknologjia ka përparuar edhe në lëmin e prodhimit të ilaçeve. Tanimë si substicioni i injeksionit përdoren me dhjetëra tablete dhe shurupe, të cilët plotësisht e zëvendësojnë atë. Edhe mjekët tashmë e kanë më të lehtë për ta bindur pacientin se zëvendësimi i injeksionit është i mundshëm dhe më praktik. Me mos përdorimin e injeksionit shumica e pacientëve, por sidomos fëmijët shpëtojnë nga traumat dhe frika që shkakton marrja e injeksionit. Por, jo vetëm

MARRIN FUND TERAPITË E VJETRA

INJEKSIONET ZËVENDËSOHEN ME TABLETA



kaq, përdorimi i injeksionit mund të ketë pasoja në infektimin e pacientit meqë jo të gjitha ambulancat tona kanë kushte të përshtatshme për këtë veprim. Shumë ambulante, sidomos ato rurale bile kanë edhe mungesë uji e jo më kushte të një standardi optimal mjekësor. Kjo do të thotë se edhe instrumentet qëllon që të mos sterilizohen në nivelin e duhur, të mos flasim këtu edhe për kushtet e ruajtjes të injeksioneve siç është temperatura e përshtatshme, e të tjera. Lidhur me përdorimin e injeksionit mjeku me përvojë të gjatë dr. Sedat Lumani thotë se më

përpara ka qenë e domosdoshme përdorimi i injeksioneve, se kultura e njerëzve ka qenë në nivel shumë të ulët dhe nuk janë përdorur ilaçe të tjera. Ndërsa tani kultura e përgjithshme dhe shëndetësore është rritur edhe te prindërit, sidomos për fëmijët ku terapia merret më me saktësi se sa përpara. Pranimi i terapi-ve ka hequr jashtë përdorimi injeksionet, të cilat thuajse nuk ekzistojnë më në treg.

"Tashmë janë tërhequr prej përdorimit shumë injeksione që nuk prodhohen si penicilini, gentamicini, etj", thotë dr. Lumani. Ai nuk përjashton faktin se kur ka

komplikime të mëdha nuk mund të pritet të shërohet me ilaçe, por shfrytëzohet injeksioni i përshtatshëm, ndonëse nuk mund të pranohen injeksionet për çdo gjë, për një dhimbje të lehtë, ose virozë kalimtare. Zhvillimi i fushës së medicinës ka bërë që shumë injeksione të zëvendësohen në formë të tabletave, për ta lehtësuar pacientin që të mos vizitojë shpesh herë spitalin.

"Ka një numër të madh të ilaçeve që nuk mund të jepen në formë të tabletave dhe atëherë është e detyrueshme që pacienti ta marrë vetëm në formën intramuskulare. Të gjitha ata që i ikin formës së aplikimit të terapi-ve paranterale ato tregojnë për një dobësi të profesionalizmit", thotë dr. Rexhep Emurllai. Sipas tij, shumë ilaçe janë të pazëvendësueshme të jepen në formë paranterale, qoftë të jepen në muskuj, në venë dhe në vende të tjera, siç edhe janë vaksinat. Sipas tij penicilina është preparati i pazëvendësueshëm dhe më pak toksike, mirëpo, sot të gjithë doktorët i ikin këtij preparati për shkak të reaksioneve anësore që ka, pra alergjive të mundshme.

"Doktorët që të mos ballafaqohen me patologjinë e reaksioneve anësore shumë më lehtë rekomandojnë ose shurupe ose preparate toksike, të cilat në fakt janë nefotoksike, etj. Domethënë përdorin preparate vetëm e vetëm që t'i shmangen përgjegjësisë së tyre profesionale. Unë jam për atë që ilaçet që kanë aplikim profesional paranteral të jenë të pashmangshëm dhe nuk ekziston asnjë protokol botëror, i cili në momentin e duhur mund ti nxjerr prej skenë aplikimin e ilaçeve paranterale", thotë dr. Emurllai. Ai shton se pacientët që vijjnë me sëmundje të rënduar si 'hasëm bronkiale' - ngufatje me frymëmarrjen në sistemin kardiovaskular, respirator ose i kafshuar prej insekteve të rrezikshme, në mënyrë alarmante kërkojnë pranimin e terapi-ve paranterale. Pra, në raste kritike është i pashmangshëm injeksioni. Edhe pse pacientët shpesh për shërim të shpejtë kërkojnë injeksione, mjekët rekomandojnë që të mos jetë prioritet ajo që kërkon pacientin, por fjala e mjekut të jetë e fundit dhe ai duhet të përcaktojë dhënien e terapi-ve, qoftë paranterale, ose në forma të tjera.

Javë më parë Qeveria miratoi ndryshimet e Ligjit të noterëve dhe atij për përmbarim me të cilin përveç që do të shlyhen kamatat dhe qytetarët do të duhet të paguajnë vetëm borxhin bazë, njëherazi do të ulen tarifat e noterëve dhe përmbaruesve. Shpenzimet e qytetarëve të cilët kanë borxhe për shërbimet komunale dhe ata të cilët kanë kredi konsumatore, në të ardhmen do të jenë më të ulta

LIGJI I RI PËR SHLYERJEN E KAMATAVE PËR BORXHILINJTË

QYTETARËT DO TË LIROHEN NGA “POLICËT” PËRMBARUES



qytetare “No Pasaran”, njehërit dhe iniciatore e nismës për grumbullimin e nënshkrimeve kundër përmbaruesve me moton “Stop Përmbaruesve”, thotë se vendimi i qeverisë ka të bënë vetëm shlyerjen e kamatave të borxheve të mbetura dhe zvogëlimin e tarifave të përmbaruesve por jo edhe për afatin e vjetërsisë së borxhit. “Vlerësoj se kështu Ligji që pritet të miratohet së shpejti nga Parlamenti nuk është i plotë dhe duhet të bëhen korrigjime. Ligji i ri nuk parasheh se si do të llogariten kamatat dhe cilat kamata do të fshihen sepse kemi kamata mbi kamatë për borxhet e mbetura dhe nëse sot të informon përmbaruesi për borxhin e kamatave, ky borxh pas dy muajve trefshohet dhe i shtohen edhe kamata tjera. Pastaj me ligj aspak nuk është përcaktuar kur vjetërsohet borxhi, sepse tek përmbaruesit kemi epilog përfundimtar të lëndëve edhe për borxhe që janë më të vjetra se 15 vite dhe se borxhi prej 5000 denarëve së bashku kamatat dhe harxhimet e përmbaruesve kalon shumën mbi 5000 euro”, thotë Ana Gligorovska, nga shoqata qytetare “No pasaran”.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 30 shtator - Këtë javë, në seancën e parë plenare të Parlamentit të Maqedonisë, në rend dite do të gjendet edhe ligji për shlyerjen kamatave të borxheve të mbetura, që qytetarët e Maqedonisë i kanë ndaj kompanive private dhe shtetërore. Javë më parë Qeveria miratoi ndryshimet e Ligjit të noterëve dhe atij për përmbarim me të cilin përveç që do të shlyhen kamatat dhe qytetarët do të duhet të paguajnë vetëm borxhin bazë, njëherazi do të ulen tarifat e noterëve dhe përmbaruesve.

PËR SHËRBIME NOTERIALE, VETËM 10 PËR QIND TË BORXHIT

Ulja e shpenzimeve të qytetarëve të cilët kanë borxhe për shërbimet komunale dhe ata të cilët kanë kredi konsumatore, në të ardhmen do të jetë më të ulta. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, për shërbime noteriale, qytetarët do të paguajnë 10 për qind të borxhit të përgjithshëm, por jo më shumë se 500 denarë.

“Kjo do të thotë se në rast se borxhi është 1000 denarë, kompensimi për notarin do të jetë 100 denarë, nëse borxhi është 10,000 denarë përsëri kompensimi do të jetë 500 denarë. Këto ndryshime ligjore priten që të vendosen përpara deputetëve për miratim. Nëse më parë shpenzimet e përgjithshme të noterit kanë qenë 3490 denarë për llogari prej 3000 denarësh, tani do të bëhen vetëm 550 denarë për noter. Në llogari prej 11,000 denarësh për rrymë dhe ngrohje, shpërblimi i noterit ka qenë 1100 denarë, tani me kufizimet r do të jetë po ashtu 500 denarë. Taksa gjyqësore prej 200 denarësh zvogëlohet, shpenzimet e avokaturës prej 4000 denarësh nuk do të paguhet. Nëse më parë

shpenzimet kanë qenë 5770 denarë, me tarifat e reja do të jenë 750 denarë. Çmimi për administrim për përmbaruesit, më përpara ka qenë 300 denarë tani do të ketë tjetër tip të kompensimit, çmimi për administrim nuk do të ekzistojë”, deklaroi Renata Deskoska ministre e Drejtësisë.

Miratimi i ligjit të ri u përkrah dhe u miratua nga shumica e deputetëve nga Komisioni amë pranë Parlamentit të Maqedonisë edhe përkundër vërejtjeve të shumta. Deputetja e BDI-së, anëtare Komisionit për punë dhe politikë sociale, Mirsade Emine-Asani, është e mendimit se Ligji i ri do të miratohet së shpejti edhe nga deputetët e Parlamentit, mirëpo pas miratimit ka nevojë të ndryshohet.

BLLOKIME TË QËLLIMSHME TË XHIROLLOGARIVE!

“Në të ardhmen do të duhet me ligj t’iu ndalohej përmbaruesve të u bllokojnë llogaritë bankare të gjithë personave që e kanë humbur vendin e punës dhe tani paraqiten si të papunë, personat që marrin ndihma sociale sidomos për borxhet e vjetra që e kanë ndaj kompanisë energjetike EVN, kompanive shtetërore si, ujësjellësi dhe kompanisë komunale higjienike, kompanive private që ofrojnë shërbime telefonike si dhe bankave që kanë lejuar kredi konsumatorësh. Të gjitha këto subjekte që po i përmendi e kanë fajin për shkak se me qëllim u kanë lejuar qytetarëve me vite të mos paguajnë faturat edhe pse kanë pasur mekanizmin

mbrojtës, pra t’iu ndërpresin furnizimin e rrymës, ujit, bisedave telefonive menjëherë me mos pagesën e faturës së dytë. E gjithë kjo është bërë në bashkëpunim me kompanitë private për interesat e tyre dhe përmbaruesve duke i rrjepur qytetarët të cilëve për borxh bazë prej 1000 denarëve kanë paguar mbi 30 mijë denarë. Me ligjin e ri do të ndalojmë ëndrrën e përmbaruesve, noterëve dhe avokatëve dhe kompanive të pasurohen në kurriz të qytetarëve të cilët me vite i kanë detyruar të vuajnë nga uria, për shkak të pamundësive financiare për të shlyer borxhet e vjetra si pasojë e kamatave të dhe tarifave të larta të përmbaruesve”, thotë Emini-Asani deputetja e BDI-së.

Ana Gligorovska nga shoqata

PËRMBARUESIT NUK DO TË HEQIN DORË NGA TARIFAT E TYRE

Nga Oda e Përmbaruesve ende nuk kanë dalur me qëndrim pas miratimit të Ligjit nga na e Qeverisë, por informojnë se janë në koordinim me përmbaruesit e tjerë për të thirru mbledhje ku pas mbledhjes do të dalin me kumtesë të përbashkët se si do të veprojnë në të ardhmen pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Nga kjo odë po ashtu thonë se ata aspak nuk janë konsultuar as nga propozuesi i ligjit të ri, as nga qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë, prandaj as që kanë ndërmend të heqin dorë nga tarifat e vjetra të përmbarimit, sepse, siç thonë, paraprakisht askush nuk i ka konsultuar apo ftuar të marrin pjesë në debatin publik të mbajtur nga komisioni amë në Parlamentin e Maqedonisë.

Ndryshe profesionit më i paguar në pesë vitet e fundit në Maqedoni është ai i përmbaruesit. Të gjithë përmbaruesit që e ushtrojnë këtë profesion nga viti 2007, kur dhe hyri në fuqi Ligji për përmbarim e që janë rreth 100 përmbarues, pesë vitet e fundit kanë realizuar të hyra të përgjithshme prej 60 milionë euro, ndërsa kanë përfutur 23 milionë euro.

ME LIGJ DO TË NDALOHET BLLOKIMI I XHIROLLOGARIVE

“Në të ardhmen do të duhet me ligj t’iu ndalohej përmbaruesve të u bllokojnë llogaritë bankare të gjithë personave që e kanë humbur vendin e punës dhe tani paraqiten si të papunë, personat që marrin ndihma sociale sidomos për borxhet e vjetra që e kanë ndaj kompanisë energjetike EVN, kompanive shtetërore si, ujësjellësi dhe kompanisë komunale higjienike, kompanive private që ofrojnë shërbime telefonike si dhe bankave që kanë lejuar kredi konsumatorësh. Të gjitha këto subjekte që po i përmendi e kanë fajin për shkak se me qëllim u kanë lejuar qytetarëve me vite të mos paguajnë faturat edhe pse kanë pasur mekanizmin mbrojtës, pra t’iu ndërpresin



furnizimin e rrymës, ujit, bisedave telefonive menjëherë me mos pagesën e faturës së dytë. E gjithë kjo është bërë në bashkëpunim me kompanitë private për interesat e tyre dhe përmbaruesve duke i rrjepur qytetarët të cilëve për borxh bazë prej 1000 denarëve kanë paguar mbi 30 mijë denarë. Me ligjin e ri do të ndalojmë ëndrrën e përmbaruesve, noterëve dhe avokatëve dhe kompanive të pasurohen në kurriz të qytetarëve të cilët me vite i kanë detyruar të vuajnë nga uria, për shkak të pamundësive financiare për të shlyer borxhet e vjetra si pasojë e kamatave të dhe tarifave të larta të përmbaruesve”, thotë Emini-Asani deputetja e BDI-së.

Sot, kjo qendër punon me kapacitet të përgjysmuar, pasi pjesa dërmuese e lokaleve në katin e dytë janë mbyllur, kurse aty këtu gjen ndonjë lokal të hapur në katin e parë. Madje, nuk kanë munguar as “çerdhet” e narkomanëve, gjë që ndikoi që shumë lokale të mbyllen dhe të largohen njerëzit

DIKUR SHKËLQENTE, SOT E BRAKTISUR

QENDRA E RE TREGTARE ME PAMJE TË ZYMTË



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 30 shtator - Lokale të mbyllura, lokale që jepen me qira dhe mosinteresim nga aksush. Kjo është pamja tashmë e dhjetë vite që e përcjell qendrën tregtare në Tetovë, dikur qendër që shkëlqente me shumë lokale të hapura, plot gjallëri dhe më shumë pastërti. Sot kjo qendër funksionon me rreth 150 lokale të hapura, kryesisht në katin përdhësë. Në katin e parë dhe të dytë funksionojnë jo më shumë se 50 lokale të ndryshme, kryesisht zyra për kontabilitet dhe zyra gjeodezike.

Sipas pronarëve të lokaleve, zakonisht gjatë verës ka gjallërim, por jo në atë masën e dikurshme, sepse tashmë në katin përdhës kanë mbetur pjesa më e madhe e artarive, të cilët akoma vazhdojnë të kenë punë. Kohë më parë, Këshilli për mirëmbajtjen e qendrës së re tregtare, përmes një apeli drejtuar pronarëve të tjerë të lokaleve që nuk janë aktiv ose që i kanë të mbyllura, ka kërkuar ato të paraqiten në

qendrën tregtare që edhe ata të japin kontributin e tyre, sepse kjo së shpejti do të krijojë kushte për funksionim të të gjitha lokaleve në këtë qendër tregtare. Ky Këshill disa herë ka tentuar të bëjë funksionalizimin dhe rregullimin e qendrës duke angazhuar pastrues dhe rregullim të ndriçimit. Megjithatë, jo çdo herë ka hasur në mirëkuptim të një pjesë e pronarëve. Sipas një pronari të një lokali, kjo qendër tregtare është lënë në mëshirë të kohës dhe tash e disa vite askush nuk është duke investuar, ndërsa

izolim të ekziston tash më pesë vite, i ka skaduar afati.

“Në kohët kur filloi me punë kjo qendër kishte lëvizje, kishte njerëz, punonin të gjithë, por duke kaluar koha, problemet dhe kriza ekonomike e kanë bërë të veten. Tash shumë lokale janë shitur, janë mbyllur dhe nuk ka perspektivë. Disa herë e kam dhënë me qira dhe nuk e ka mbajtur askush, sepse nuk ka punë”, thotë pronari i një kafiterie në katin e parë. Por kohëve të fundit mosinteresimi për këtë qendër e ka bërë të veten, e njëjta

ka probleme me kanalizimin atmosferik dhe me izolimin. Kështu që kur ka të reshura, grumbullohet uji, kurse kanalizimi jofunksional bën që uji të depërtojë edhe në lokale për shkak të mos izolimit të mirë.

E ndërtuar në vitin 1995, e njëjta në fillim shkëlqente pasi pjesa dërmuese e lokaleve ishin të hapura dhe punonin, kurse frekuentimi i qytetarëve ishte më i madh. Por me kalimin e kohës kjo qendër humbi atë shkëlqim, kjo për shkak të problemeve të shumta sidomos për shkak të rrahjeve dhe zënkave brenda në qendër. Madje, nuk kanë munguar as “çerdhet” e narkomanëve, gjë që ndikoi që shumë lokale të mbyllen dhe të largohen njerëzit. Sot kjo qendër punon me kapacitet të përgjysmuar, pasi pjesa dërmuese e lokaleve në katin e dytë janë mbyllur, kurse aty këtu gjen ndonjë lokal të hapur në katin e parë. Jo rrallë herë janë marrë iniciativa të ndryshme që kjo qendër të rivitalizohet dhe të kthehet në gjendje normale, por dita ditës edhe këta iniciativa janë shterur si pasojë e mosinteresimit të pronarëve të lokaleve, të cilët dhanë mijëra e qindra mijëra euro për të blerë lokale 23 vite më parë, kurse sot as qiratë nuk mund të marrin nga lokalet e tyre.

Rritet numri i punëtorëve në industri

Shkup, 30 shtator - Numri i punëtorëve në industri në muajin gusht të vitit të kaluar shënon rritje prej 5.3 për qind, kumtoi Enti shtetëror për statistika.

Numri i punëtorëve në sektorin Xehitari dhe nxjerrje e gurëve në gusht të këtij viti, në krahasim me gushtin e vitit të kaluar shënon rritje prej 1.9 për qind, në sektorin Industria përpunuese rritje prej 5.7 për qind dhe në sektorin Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatisim prej 1.7 për qind.

Sipas grupeve kryesore industriale të punëtorëve në industri në gusht të vitit 2018, në krahasim me gushtin e vitit 2017, shënon rritje tek prodhimet intermediare, përveç energjisë për 8.3 për qind, prodhimet kapitale për 21.5 për qind, prodhime të paqëndrueshme për konsum të gjerë për 0.2 për qind dhe tek energjia për 0.4 për qind, përderisa rënie shënon tek prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë për 1.4 për qind.

Numri i punëtorëve në industri në periudhën janar-gusht 2018, në krahasim me periudhën janar-gusht 2017 shënon rritje prej 7.2 për qind.

NË PRITJE TË FAZËS SË DYTË TË NDËRTIMIT TË BULEVARDIT

SHKOI VERA, “BLLAGOJA TOSKA” NË VENDNUMËRO

Gjatë muajve të verës korrik, gusht, por as në shtator nuk janë zhvilluar punime, ndërsa i njëjti vend shfrytëzohet për parking. Situata pritet të vështirësohet tani gjatë vjeshtës kur do të ketë reshje dhe kjo rrugë do të jetë e pakalueshme, thonë banorët, të cilët këtë pamje e kanë përjetuar edhe viteve të kaluara



vijuar me punët. Gjatë muajve të verës korrik, gusht, por as në shtator nuk janë zhvilluar punime, ndërsa i njëjti vend shfrytëzohet për parking. Situata pritet të vështirësohet tani gjatë vjeshtës kur do të ketë reshje dhe kjo rrugë do të jetë e pakalueshme, thonë banorët, të cilët këtë pamje e kanë përjetuar edhe viteve të kaluara. Nga komuna informuan se po pu-

nohet intezivisht në shpronësimin e tokës së mbetur nga pronarë të tjerë, procedurë kjo e cila pritet të zgjasë deri në fund të këtij viti dhe më pas të fillohet me fazat tjera të hapjes së këtij bulevardit.

“Ne si komunë i jemi qasur seriozisht këtij problemi, që nënkupton kemi filluar me eskroprijimin dhe më pas kur të fillohet ndërhyrja e kompanisë që ka fituar

tenderin, të mos ketë ndërprerje të tilla. Fillimisht pagesat do të bëhen dhe normalisht kompania, e cila fituar tenderin në ditën kur do të fillojë realizimin e punëve, të mos has në pengesa”, tha Armend Fazliu, zëdhënësi i Komunës së Tetovës. Nga Sektori për tokë ndërtimore dhe komunikacion pranë Komunës së Tetovës shprehen se në këtë mandat, hapja e këtij bulevardi do të jetë prioritet. Nga atje shprejnë se vitin e ardhshëm do të fillohet intenzivisht të punohet.

“Ky është vetëm fillimi për hapjen e këtij bulevardi, ndërsa shpresojmë që deri në fund të vitit, të përfundojë procesi i shpronësimit me të gjithë pronarët dhe vitin tjetër të fillojë ndërtimi i trasesë së rrugës nëse eventualisht nuk ka ndonjë pengesë shtesë”, thonë nga ky sektor. Në fazën e dytë gjatë procesit të ekspropriimit do të rrenohen 19 objekte në këtë bulevard. Përndryshe, arsytimi i autoriteteve të Komunës së Tetovës për mo-

srealizimin e këtij projekti ka qenë ndërtimet pa leje që janë në procedurë legalizim.

Bulevardi “Bllagoja Toska” fillon të unaza tek ish-restorant “Mema” dhe përfundon tek stadiumi i qytetit. Ky bulevard është një nga arteriet kryesore të qytetit të Tetovës, hapja e të cilit do të lehtësonte qarkullimin e automjeteve dhe njerëzve edhe në pjesët tjera të qytetit. Banorët disa herë kanë thënë se janë të gatshëm të bëjnë marrëveshje me Komunën për kompensim, por edhe ata disa herë janë shprehur skeptik rreth seriozitetit të komunës për të realizuar deri në fund këtë projekt, i cili gjithsesi sipas autoriteteve të Komunës së Tetovës, ka kosto të lartë për realizim.

Në ndërkohë, organet kompetente të Komunës së Tetovës kanë mbyllur rrugën që lidhte bulevardin e Ilindenit me spitalin e Tetovës në afërsi të urës së lumit Shkumbin. (U.H)

Revansh i ri ballkanik i Rusesë nga Bosnja



Nga
Shaban MURATI

Një arsye shumë e fortë duhet ta ketë shtyrë ministrin e jashtëm rus, Sergej Lavrov, të ndërmarrë në 21 shtator vizitën në Sarajevë dhe në Banja-Luka të Bosnjë-Hercegovinës, duke bërë një devijim të zhurmshëm nga norma diplomatike, sipas së cilës diplomacia nuk zhvillon vizita të nivelit të lartë në një shtet, që ndodhet në fushatë elektorale. Dy javë para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të 7 tetorit në Bosnjë-Hercegovinë shefi i diplomacisë ruse shkon atje në kulmin e fushatës elektorale në një akt ndërhyrje të hapur në procesin elektorale të Bosnjë-Hercegovinës, sepse është e njohur ndërkombëtarisht që Moskë është palë me entitetin dhe udhëheqësin separatist të "Serpska republikës".

Moska po manifeston një padurim të madh për ambicien e beniaminit të saj Milorad Dodik që të fitojë postin e përfaqësuesit presidencial serb në presidencën trepalëshe, që drejton shtetin e Bosnjë Hercegovinës. Nëse Dodik do të bëhet anëtar i presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, kjo do të përbente një fitore të diplomacisë dhe të influencës ruse në shkallë shteti, sepse bllokimi i funksionimit të shtetit unik do të arrinte shkallën më të lartë, gjë që është objektiv i Rusesë.

Institucionet dhe shërbimet ruse po punojnë me kapacitet të plotë për ta kryer fitoren e Dodikut në postin e anëtarit të presidencës së shtetit. Në funksion të kësaj ministri i jashtëm rus bëri vizitë të posaçme pompoze në Banja-Luka, kryeqendra e "serpska republikës". Si në një miting elektorale Lavrovi i thuri elozhe publike udhëheqjes së Dodikut dhe kontributit të tij të posaçëm në marrëdhëniet e posaçme midis Rusesë dhe "srpska republikës", madje formatoi fjalimin sikur ishte në shtetin e pavarur të "serpska republikës". Në fjalën e mbajtur në konferencën shtypit në Banja-Luka bashkë me Dodikun, Lavrov evokoi "nyjet e miqësisë dhe rrënjët historike e shpirtërore që lidhin dy popujt tanë", duke sanksionuar statusin e një marrëdhënie midis dy shteteve të pavarura.

Në funksion elektorale e filorus ishte lënë qëllimisht që Lavrovi të vendoste gurin e themelit të ndërtimit në qendër të Banja-Lukës të katedrales së madhe ortodokse

ruse, e cila do të drejtohet nga priftërinj rusë dhe do të jetë bosh-ti i Qendrës së re të kulturës ruse në Banja-Luka. Në funksion elektorale Moskë dërgoi para Lavrovit në Banja-Luka për të mbështetur udhëheqësin separatist serb Dodik presidenten e Këshillit të Federatës Ruse, Valentina Matvijenko, dhe guvernatorin e Shën Petërburgut dhe një nga njerëzit më të afërt të presidentit rus, Georgij Poltavçenko. Dhe si për për t'i venë kapakun mbështetjes ruse, pas vizitës së Lavrovit Banja-Luka njoftoi se vetë presidenti Vladimir Putin do të presë Dodikun në Soçi pak ditë para zgjedhjeve.

Kjo mbështetje kaq e hapur diplomatike, politike, financiare dhe e shërbimeve sekrete, që Moskë po i jep udhëheqësit radikal nacionalist të serbëve të Bosnjës është mbështetje për kursin separatist të tij dhe lidhet me rolin destabilizues, që rusët i kanë caktuar atij për të luajtur kartën destruktive brenda shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, por edhe më gjerë në rajonin e Ballkanit. Kjo shpjegon paradoksin diplomatik që presidenti rus Vladimir Putin e ka takuar tetë

herë udhëheqësin e serbëve të Bosnjës, Dodik, që në fund të fundit është drejtues i një entiteti lokal në një shtet të vogël ballkanik, që është shumë larg kufijve ruse.

Moska ka interes strategjik që "serpska republika" të shkëputet nga Bosnjë-Hercegovina. Milorad Dodik i ka ofruar zyrtarisht Moskës që të vendosë një bazë ushtarake ruse në territorin e "serpska republikës". Jo rastësisht në konferencën e përbashkët me Lavrovin, Dodik u ankua që në Ballkan ka ushtarë perëndimorë, por nuk ka ushtarë rusë. Burime diplomatike bëjnë të ditur se aktualisht po zhvillohen bisedime të fshehta midis Moskës dhe Banja-Lukës për të ndërtuar në "serpska republika" një të ashtuquajtur bazë humanitare ruse si ajo e Nishit në Serbi.

Rëndësinë e veçantë, që Moskë po i jep presidentit të "serpska republikës", e shpjegon qartë gazeta e mirënjohur ruse "Komersant", e cila në artikullin e saj të datës 22 shtator, kushtuar vizitës së Lavrovit në Banja-Luka, shkruan: "Hyrja e M.Dodikut në presidencën e Bosnjë-Hercegovinës i vjen për shtat Moskës. Zgjedhja e tij faktikisht e

Rusia, duke parë që Ballkani po i rrëshqet nga influenza, sidomos pas anëtarësimit të Malit të Zi në NATO dhe hapjes së perspektivës së shpejtë atlantike të Maqedonisë me marrëveshjen për emrin me Greqinë, po nxiton të riorganizojë forcat dhe mundësitë, që i kanë mbetur në shahun gjeopolitik ballkanik. I kanë mbetur dy ushtarë në fushë: Beogradi dhe Banja-Luka, të cilët po i aktivizon jo për të turbulluar lojën, rregullat dhe Ballkanin



bllokon procesin e mëtejshëm të bashkimit të Bosnjë-Hercegovinës me BE dhe me NATO-n". Gazeta ruse shpjegon pra thelbin e ofensivës diplomatike të Moskës në Banja-Luka. Moskë po kalon në një fazë të re të revanshit të saj diplomatik dhe politik në Ballkan për të aktivizuar më fort ushtarët e saj në fushën e shahut gjeopolitik ballkanik dhe ku aktualisht ka mbetur vetëm me dy ushtarë: Banja-Luka dhe Beogradi.

Kaq i dobët është pozicioni diplomatik i Moskës në Ballkan, sa që ministri i jashtëm rus nuk po ruan as etiketat formale të marrëdhënieve ndërshtetërore, por thirri për bisedime në Banja-Luka në 21 shtator edhe zëvendëskryeministrin dhe ministër i jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiç. Lavrovi e kishte thirrur Daçiçin për bisedime në Rusi edhe në datën 28 qershor 2018, edhe në datë 21 gusht 2018. Ç'janë këto bisedime urgjente në Banja-Luka në datën 21 shtator, në territorin e një shteti tjetër dhe në një entitet artificial, i cili rivendikon bashkimin me Serbinë? Në gjuhën e taktikës kjo mund të quhet mobilizim diplomatik i poli-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përrhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 30 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tikanëve dhe i forcave proruse në terrenin ballkanik.

Moska po kërkon hapur t'i kundërvihet Bashkimit Europian dhe Perëndimit dhe po ngre me forcë të re pretendimin për sferën e saj të influencës në Ballkan. Dhe po shpall sanksionimin e sferës së saj të influencës në dy entitetet serbe: "Serpska republika" dhe Serbia. Është një lëvizje diplomatike ruse, e cila kërcet. Siç kërciti në Banja-Luka pretendimi i hapur i ministrit të jashtëm rus, i cili iu drejtua BE me kërkesën publike që t'i hapë vend Ruisë për pjesën e saj të influencës në Ballkan.

Në një intonim të pashembullt antidiplomatik, Lavrov sulmoi në Banja-Luka shefen e politikës së jashtme të BE, Federika Mogherini, sepse sipas tij në fillim të muajit shtator ajo ka deklaruar se Ballkani është territor i Bashkimit Europian. Federika Mogherini nuk ka bërë asnjë gabim, por ka pohuar një realitet, një të vërtetë diplomatike, historike dhe juridike, sepse të gjitha shtetet e Ballkanit pa përjashtim janë anëtarë ose kanë kërkuar të bëhen anëtarë të BE. Madje edhe Serbia, që është aleate strategjike e Ruisë, është shtet kandidat i BE dhe ka hapur bisedimet e pranimit me BE.

Edhe Bosnjë-Hercegovina, me konsensusin edhe të "serpska republikës", ka kërkuar të bëhet anëtare e BE. Ndaj sulmi diplomatik i Lavrovit kundër BE në fakt i kundërvihet vijës zyrtare të të gjitha shteteve të rajonit, të cilat e shohin të ardhmen e tyre me BE-në. Shqetësimi real i diplomacisë ruse është që BE dhe SHBA të pranojnë Rusinë në fushën ballkanike dhe t'johin asaj të drejtën e pjesës së sferës së influencës. Nuk është e rastit që diplomacia ruse po e shqëron këtë ofensivë edhe me disa nisma e lëvizje të reja. Një nga këto është propozimi i ri i Moskës, që e bëri të ditur anëtari serb i presidencës trepalëshe boshnjake pas takimit me Lavrovin në 21 shtator, se Rusia ka propozuar që të organizohet një format i katër shteteve: Rusi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Turqi, për të diskutuar çështjet e Bosnjë-Hercegovinës.

Është një nismë që synon të legalizojë rolin e posaçëm të Ruisë në Bosnjë dhe të drejtën e ndërhyrjes ruse atje. Sipas të njëjtit burim, kërkesën e Ruisë nuk e ka pranuar Bakir Izetbegović, anëtari i presidencës trepalëshe, i cili përfaqëson popullin boshnjak, që është populli më i madh i shtetit.

Në të njëjtën kohë Moskë po lëviz të përfitojë nga situata inkandeshente midis Serbisë dhe Kosovës në prag të arritjes së një marrëveshje përfundimtare të normalizimit të marrëdhënieve midis tyre. Moskë po kërkon të rifitojë rol në bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës, duke përdorur udhëheqjen e Beogradit, e cila po ngulmon që të jetë edhe Rusia në tratativat midis Serbisë dhe Kosovës. Pas takimit me Lavrovin ministri i jashtëm serb deklaroi se pa Rusinë nuk mund të ketë marrëveshje me Kosovën. E habitshme është që në favor të një rifutje të Ruisë po shfaqen disa qëndrime dhe teza disfatiste nga Prishtina, sipas të cilave Serbinë nuk mund ta detyrojë të njohë Kosovën as SHBA, as BE dhe as NATO, ndaj duhet ftuar edhe Rusia. Këto janë qëndrime që vijnë erë ruse dhe serbe.

Rusia, duke parë që Ballkani po i rrëshqet nga influenza, sidomos pas anëtarësimit të Malit të Zi në NATO dhe hapjes së perspektivës së shpejtë atlantike të Maqedonisë me marrëveshjen për emrin me Greqinë, po nxiton të riorganizojë forcat dhe mundësitë, që i kanë mbetur në shahun gjeopolitik ballkanik. I kanë mbetur dy ushtarë në fushë: Beogradi dhe Banja-Luka, të cilët po i aktivizon jo për të fituar Ballkanin, por për të turbulluar lojën, rregullat dhe Ballkanin. (BalkanWeb)

Europa, tokë e lakmuar



Nga
Angelo PANEBIANCO

Europa duhet të mbajë parasysh gjallësinë këmbëngulëse të shteteve kombëtare. Por, europeanët që pësojnë yshtjen e kushtimit nacional-populist duhet të dinë mirë se çfarë çmimi do të paguajmë të gjithë, nëse ai projekt do të sendërtohej.

I drejtohem me shumë shembëllesave historike kur kohët turbullohen, kur shkimen pikat e referimit të zakonshëm, ato që më parë përdornim për të ndërpretuar botën. Kërkohen, në historinë e shkuar, çaste e gjendje të krahasueshme, për aq sa është e mundur me rrethanat e pranishme, me shpresë të gjendet një busull që të na ndihmojë në të drejtohem.

Ta zëmë se Steve Bannon, ish-ortaku i Donald Trumpit e teoriku i nacional-populizmit, dhe mendimi i tij (ai që shumëve prej nesh na duket një distopi, një utopi e keqe) për një Europë të rihedhur në garën mes Shtetesh, plotësisht sovranë, do të fitojnë. Ta zëmë se në zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin Europian do të vërtetohet fitorja e madhe zgjedhore e nacional-populistëve.

Ta zëmë se do të rritet kushtëzimi i ushtruar mbi qeveritë gjermane nga Alternativa për Gjermaninë, një lëvizje kundër të huajve (dhe kundër Europës), sot partia e tretë në Bundestag, që në Francë rënia e pëlqimit popullor për Macronin do ta bëjë përsëri të besueshme sfidën lepeniste, që në Itali do të ngulin rrënjë nacional-populistët, sot në fuqi, e që lëvizje të tilla do të vazhdojnë të fuqizohen gjithandej. Bashkimi Europian, larg kalimit të krizës së sotme, do të kishte pak mundësi të merrte veten.

Le të përfytyrojmë, së fundi, se lidhjet ndëratlantike (edhe për shkak të ripohimit të një mandati të dytë presidencial të Trumpit, mbas dy vitesh), do të vazhdojnë të dobësohen. Nëse gjithçka u tha më sipër do të sendërtohej, cilës hyllësie historike duhet t'i drejtohem për t'u rrekur të kuptojmë gjendjen e re europiane? Mund të kuturisim që në këtë rast Europa do të gjendet në kushte të krahasueshme me ata të Italisë në gjysmën e parë të Pesëqindëshit: në harkun e kohës që shkon nga 1494, vit i zbritjes në Itali të mbretit të Francës, Karli VIII, deri në 1559, viti i traktatit të paqes të Cateau-Cambrésis. Gjatë gjithë asaj periudhe, me pushime të shkurtra, Franca e Spanja (Franca dhe Perandoria Habsburge nën Karlin V, nga 1519 deri në 1556,) luftuan për kontrollin e Italisë. Sherret mbaruan më 1559 me ngadhënjimin e Spanjës, që siguroi mbizotërimin, nga Mbretëria e Napolit në Milano, në një pjesë të mirë të Gadishullit. Italia mbas 1494 ishte bërë tokë e lakmuar nga fuqitë Europiane sepse kishte dy karak-



Elitat europeiste apo kozmopolite që mendonin se në Europë shteti kombëtar tashmë ishte tejkaluar, kanë bërë gabime të mëdha. Kanë lehtësuar kundërveprimin sovranist. Europa duhet të mbajë parasysh gjallësinë këmbëngulëse të shteteve kombëtare. Por, europeanët që pësojnë yshtjen e kushtimit nacional-populist duhet të dinë mirë se çfarë çmimi do të paguajmë të gjithë, nëse ai projekt do të sendërtohej

teristika (që i gjejmë edhe në Europën e sotme): ishte e pasur në burime ekonomike dhe në prestigj dhe ishte politikisht e copëtuar, e ndarë në Shtete shemra, të paaftë të formonin një front të përbashkët kundër orekseve të atyre fuqive.

Në një vepër klasike kushtuar "Historisë së republikave italiane" më 1832, historiani dhe ekonomisti Sismondi shkruan: "Në fund të shekullit XV zotërinjtë e kombeve francez, gjerman e spanjoll u tunduan nga begatia e vetëm një qyteti u premtonte atyre herë-herë më shumë pasuri se sa mund t'i zhvatnin miliona vartësve. Me pretekstet më të kota ata mësynë Italinë e cila, në dyzet vite lufte, herë pas here u shkatërrua nga gjithë ata popuj që mundën të depërtonin në të. Grabitjet e këtyre barbarëve të rinj shkaktuan zhdukjen e begatisë që i kishte joshur ata".

Le të mbajmë parasysh tani rastin e një Europe "të shprishur": fundi i hegemonisë së Shteteve të Bashkuara, fundi i integritimit Europian, kthimi i plotë në Europën e Shteteve kombëtare të palidhura - siç kanë qenë deri tashti - nga ajo hegemoni dhe nga ai integritim.

Të përfytyrojmë gjendjen më ngjyrë trëndafili, një skenar në të cilin të mos jenë të pranishme, në ndryshim nga çfarë ndodhi në Italinë e Pesëqindit, kundërshtitë e armatosura (edhe se e dimë se gjatë kufirit mes Vendeve të

NATO-s dhe zonave të ndikimit rus, shpejt a vonë mund të shpërthejnë përplasje të rënda). Europa gjithsesi do të jetë tokë e lakmuar e fuqive të mëdha. E para që do të përfitonte nga rënia e hegemonisë amerikane dhe ndalimi i njëhershëm i integritimit Europian, natyrisht do të ishte Rusia (e cila, së bashku me disa miq të saj Europianë, po punojnë me zell për atë përfundim). Do të synonte të zëvendësonte Shtetet e Bashkuara në rolin e lordit mbrojtës të Europës. "Asgjë e keqe" thonë ata që nuk kuptojnë se çfarë pasojash do të kishte mbi shoqërinë në të cilën bëjnë pjesë e mbi vetë jetët e tyre, kalimi nga hegemonia e një fuqie demokratike e liberale në atë të një Shteti iliberal.

Merrni me mend: ekspertët e Ruisë mendojnë se Putini është më i miri që gjendet në sheshin e atyre anëve. Pasesit e tij, për pjerrje autoritare dhe prirje imperialiste, do të jenë me gjasë, më të këqij. Por Rusia nuk do të kishte fushë të lirë. Do të haste pengesa në veprimin e të tjera fuqive të mëdha. Edhe se politikisht të kufizuar, jo më në gjendje të ushtrojnë një hegemoni të pakundërshtueshme, Shtetet e Bashkuara, sigurisht nuk do të braktisnin krejtësisht fushën: do të kërkonin gjithsesi të kundërshtonin trysinë ruse mbi Europën. Pastaj është Kina me synimet e saj perandorake, rruga e re e Mëndafshit, e gjithçka tjetër me investimet e saj të mëdha jo vetëm në Azi dhe në Afrikë, por edhe në Mesdhe e në Europë. Europa e pasur dhe e ndarë do të bëhej pre (të shpresojmë së paku, paqësore) e garës ndërmjet fuqive të mëdha të sotme. Në një Europë të ndarë do të rindizeshin shumë shemëri, deri tani (mbas 1945) vetëm të fashitura: ndosh-ta kundërshtia e fortë mes Italisë dhe Francës mbi Libinë paralajmëron një fazë tensioni ndërmjet Europianëve për çështjet më të ndryshme.

Nga ana tjetër, rifillimi i tensioneve do të lehtësonte, kryesisht në Vendet Europiane më pak të fuqishme, lindjen e grupeve partiake ose të rrymave të partive, të lidhura me fille dyfishe me njëri-njëri apo tjetër fuqi të madhe rivale. Nuk po zëmë në gojë faktin që në një Europë të ndarë, dhe tokë mërgimi nga Lindja e Mesme, do të shtoheshin akoma më tepër prania dhe aftësia e ndikimit të ndonjë fuqie (autoritare) të asaj zone. Elitat europeiste apo kozmopolite që mendonin se në Europë shteti kombëtar tashmë ishte tejkaluar, kanë bërë gabime të mëdha.

Kanë lehtësuar kundërveprimin sovranist. Europa duhet të mbajë parasysh gjallësinë këmbëngulëse të shteteve kombëtare. Por, europeanët që pësojnë yshtjen e kushtimit nacional-populist duhet të dinë mirë se çfarë çmimi do të paguajmë të gjithë, nëse ai projekt do të sendërtohej.

Shabani mesazh Kosovës dhe Shqipërisë

Meritan Shabani është kthyer në një çështje diskutimi mbi zgjedhjen që ai do të bëjë. Pra se cilën Kombëtare do të vendosë ta përfaqësojë ai. Edhe pse disa javë më parë talenti i Bayernit të Munichit u grumbullua me të rinjtë e skuadrës Kombëtare të Gjermanisë, tashmë i ka dhënë sinjale pozitive Shqipërisë dhe Kosovës. Ditën e sotme Shabani ka postuar në rrjetin social "Instagram" një "story" ku duket fanella e tij të Bayerni i Munichit dhe "emoji" me flamurin e Shqipërisë dhe Kosovës.



Ramadan Shabani i dyti në botë, Ismet Feruki i pesti

Shkup, 30 shtator - Në Kampionatin Botëror për veteran që po mbahet në vendin tonë përfaqësuesit e Maqedonisë arritën sukses të madh, duke fituar një medalje të argjendtë dhe një vend të pestë. Ramadan Shabani arriti sukses historik dhe fitoi medaljen e argjendtë në divizionin D, kategorinë deri me 78 kg, pasi në finale humbi nga përfaqësuesi turk Ismail Abi, ndërsa po në divizionin e njëjtë, kategorinë deri me 88 kg. Më herët Ramadani kishte arritur fitore ndaj mundësit nga Kazakistani, Trupalali Sulimanov me rezultat 6-2, dhe në gjysmë finale fitoi përballë mundësit japonez Kacuja Otikava. Mundësi, Ismet Feruki u ndal në finalen e vogël, duke humbur nga rusi Erelar Feizullaev. Isa Fejzula në kategorinë 130 kg, i humbi të dy luftat, ndërsa do të përballë për medaljet e bronzit, mirëpo në këtë kategori janë vetëm 3 garues, kështuqë Fejzula do të fiton medaljen e bronzit. (F.N)

Ramadani, udhëheqës i padiskutueshëm në ringun në Zvicër



Shkup, 30 shtator - Hadis Ramadani është udhëheqës i padiskutueshëm në ringun në Zvicër, paso të shtunën në mbrëmje ka arritur të shënon fitoren e 11 në ballafaqimin e 11 në kik-boks në ringun profesional. Ramadani në meçin e të shtunën ka arritur të fiton përballë italianit Leonardo Pllukino në Fajt-Najt rastin në VKU - Zvicër. (F.N)

LIGA E PARË - JAVA E VIII

RENOVA THELLON KRIZËN E SHKUPIT, SHKËNDIJA SËRISH NUK FITON

FC Shkupi pësoi disfatë 0-2 në Tetovë ndaj Renovës. Jusufi dhe Stojanovski vulosën shpresat e FC Shkupit për të bërë diç më tepër në sfidën e javës së 8. Kuqezinjtë ndalen me barazim pa gola përballë Akademia Pandevit në takimin e xhiros së tetë të Ligës së Parë të futbollit të Maqedonisë e luajtur në Turnovë

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 30 shtator - Të shtunën janë zhvilluar ndeshjet e javës së tetë në Ligën e Parë futbollistike. Derbi i javës mes dy ekipeve shqiptare Renovës dhe Shkupit ka përfunduar në favor të ekipit tetovar të cilët në shtëpi mundën 2:0 Shkupin, duke regjistruar fitoren e 2 radhazi në kampionat. Zhblllokimi i rezultatit erdhi në minutën e 19 kur Jusufi shënon për epërsi 1:0 të Renovës, ndërsa goli që vulosi fatin e takimit u shënuar në minutën e 56 kur Stojanovski nga pika e bardhë vulosi rezultatit



përfundimtar 2:0. Kampioni aktual Shkëndija pas disfatës në mesjavë nga Pobeda në Tetovë, edhe në takimin e xhiros së tetë si mysafire e Akademia Pandev nuk ka arritur ti merr tre pikët dhe ky rezultat ka lënë të pakënaqur të gjithë në taborin kuqez. Ekipi nuk arrin të fitojë dy ndeshje me radhë dhe kjo ecuri nuk do filozofi për të konstatuar se skuadra është në moment krize. Trajneri Qatip Osmani potencon se ekipi ndjen edhe lodhjen nga tetë paraqitjet evropiane. "Sigurisht se brengos fakti se ne nuk arrijmë të shënojmë gol dy ndeshje me radhë, diçka që nuk na ka ndodhur gjatë kohë. Kemi problem me realizimin, megjithatë jam i kënaqur me angazhimin e lojtarëve. Mirëpo u përsërit ajo që ndodhi edhe me Pobedën, pasi ne nuk

krijojmë raste dhe problem kryesorë mbetet realizimi. Është e evidente se Shkëndija është në një krizë dhe ajo që duhet të bëjmë është të tentojmë sa më shpejt të dalim nga ky moment. Nuk kërkoj arsyetim dhe alibi, por konstatimi im është se ndiejmë lodhje nga ndeshjet e Evropës. Faktikisht ne zhvilluam tetë ndeshje në Evropë dhe ekipi fillon të ndiejë lodhjen tani në këtë fazë", shprehet trajneri Qatip Osmani, i cili potencon se në skuadër ndjehet krizë. Vardari ka shënuar edhe fitoren e 6 sezonale në 8 javët e para të sezonit të ri në Ligën e Parë Futbollistike të Maqedonisë, duke konfirmuar se ndodhet në një formë të mirë, pavarësisht krizës financiare që ka kapluar këtë klub. Ekipi i Vardarit arriti të shënon fitoren në terren vendas

REZULTATET:	
RENOVA - SHKUPI	2:0
AKADEMIJA P.- SHKËNDIJA	0:0
POBEDA- VARDARI	0:1
SILEKSI - MAK.GJ.P.	1:1
RABOTNIČKI - BELLASICA	1:1

duke mundur Pobedën në Shtip me rezultatit minimal 1:0, ku golin e vetëm e realizuan në pjesën e dytë të takimit, me anë të Vilian Lira në minutën e 57 të përballjes. Vardari falë fitores së arrin në kuotën e 20 pikëve dhe me meritë kryeson renditjen. Në takimet tjera Rabotnički barazoi 1:1 me Bellasicën, më të njëjtin rezultat përfundoi edhe takimi mes Sileksit dhe Makedonija Gjorçe Petrovit. Vardari vazhdon kryesimin në renditje me 20 pikë të tubuara, e ndjekur nga Akademia Pandevi me 16 pikë dhe Shkëndija me 15 pikë.

LIGA E DYTË

Struga Trim Lum fiton ndaj Korabit

Shkup, 30 shtator - Të shtunën janë luajtur ndeshjet e javës së shtatë në Ligën e Dytë futbollistike të Maqedonisë, Lindje dhe Perëndim. Java e 7 në Perëndim ka sjellë rezultate befasesues. Ekipi i Pelisterin ka arritur të merr fitoren e parë sezonale duke mundur liderin e deritanishëm Gostivarin me rezultatit 2:1. Në derbin e madh të javës, Vëllazërimi me rezultatit 2:3 në transfertë mundi Genç Kalemler. Në derbin shqiptar ekipi i Struga Trim Lum shënoi fitore ndaj Korabit me rezultatit 2:0. Më këtë fitore ekipi strugan rimerr kreun e tabelës me 14 pikë të tubuara. Fitore ka arritur edhe Labunish-ta që në transfertë mundi Silek-



sin, ndërkohë Goblen Junior edhe në ndeshjen e saj të katërt si vendas ka barazuar pa gola ndaj Skopjes. Skuadra e Borecit nuk dinë për humbje ata edhe këtë javë kanë vazhduar me

ecurinë e fitoreve. Këtë herë arritën të shënojnë fitore ndaj ekipit të Vardar Negotina me rezultatit minimal 1:0. Për ekipin e Borecit janë aktivizuar dy shqiptarët portieri Burhan Musta-

fa dhe mbrojtësi Leonard Kal-laba. Ndërkohë edhe ekipi i Kozhuvit ku aktivizohet Emir Skenderi ka arritur të shënon fitore ndaj ekipi nga Gjevgjelia, Plačkovica me rezultatit 3:1. Befasia e javës së shtatë në Ligën e Dytë-Lindje ka ardhur nga ekipi i Detoni Juniro të cilët kanë arritur të regjistrojnë fitoren e parë për këtë sezon pas 6 humbjeve rresht. Ekipi i Detonit Xhunior mposhti Bregallnicën me rezultatit 2:0. Në përballjet tjera ekipi i Kit Go që si mysafir me rezultatit 0:2 mundi Partizan Obrshani, Kamenica Sasa pësoi disfatë në terren vendas me rezultatit 1:3 përballë Tikveshit. (F.N)

LORIK CANA: DJALI IM DO TË SHOQËROHET ME SPORTIN

“Nuk e di nëse do e bëjmë futbollist por patjetër që do të shoqërohet me sportin, do të merret me sportin. Një gjë është e detyruar të merret me sportin pastaj profesionin që do të zgjedh, ai është zgjedhja e tij”, ka theksuar Cana

Lorik Cana është shpallur ambasadori shqiptar i sportit në mbrëmjen gala “Albanian Sport Ambassador”. Në një intervistë për Telesport ka treguar për emocionet që dashuria e shqiptarëve transmeton tek ai. Gjithashtu ka zbuluar se djali i tij, Boikeni ka mundësi të rivalizojë CR7 Jr pasi, Cristiano nuk e ka pasur babain futbollist të suksesshëm ndërsa Loriku po. “Unë mundohem të mbaj emocionet dhe një lloj ftohtësie, por të jeni të sigurt që brenda është një vullkan që vlon nga emocionet pozitive. Sepse të tjerët të vlerësojnë, jo vetëm mua por të gjithë ne që jemi pjesë të sportit dhe jemi munduar të bëjmë më të mirën për të ngritur lart Shqipërinë. Patjetër që është një kënaqësi e jashtëzakonshme pasi ajo që mbetet janë kujtimet, trofet dhe ajo që mbetet përgjithmonë është dashuria dhe respekti i njerëzve, e kjo nuk ka çmim”, ka deklaruar Cana. I pyetur se a do ta bëjmë edhe Boikenin fut-



bollist të kombëtares Cana është përgjigjur se ende nuk ka vendosur se a do të jetë djali i tij futbollist, mirëpo do të shoqërohet me sportin. “Nuk e di nëse do e bëjmë futbollist por patjetër që do të shoqërohet me sportin, do të merret me sportin. Një gjë është e detyruar të merret me sportin pastaj profesionin që do

të zgjedh, ai është zgjedhja e tij”, ka theksuar Cana. Për këtë Lorik Cana duhet ta mendoj mirë se a do të djali i tij futbollistë, pasi CR7-së përshembull i është bërë djali më i mirë se i ati, kështu që dhe Boikeni mund të të rivalizojë? “Ai ka edhe një avantazh, se CR7 nuk e ka pasur babain futbollist të suksesshëm, ndërsa unë e kam

pasur babain futbollist të suksesshëm dhe jam bërë më i mirë se ai, e për t’u bërë më i mirë se unë absolutisht që ka shumë shanse, por është edhe më e vështirë. Por gjithsesi siç thashë me rëndësi është (Boikeni) të rritet me vlerat e sportit dhe ajo s’do të mungojë asnjëherë”, është shprehur Lorik Cana.



Tare:
Pasardhësi im në Shqipëri? Çmimin do ta ndaja me Bushin

Iglli Tare pasi ka marrë çmimin e karrierës në “Albanian Sport Ambassador”, ka treguar për Telesport rreth ndjesive që përjetoi pas marrjes së një çmimi të tillë, në vendin e tij të zemrës. “Unë ndihem si në shtëpinë time. E thashë edhe në podium që është një kënaqësi e veçantë pasi është hera e parë që marr një vlerësim të tillë në Shqipëri. Ndihej shumë mirë pasi e kuptoj që më në fund të gjitha mundimet dhe sakrificat që kemi bërë patën një vlerë të veçantë. I pyetur se cilin nga futbollistët tanë, e shikoni si pasardhësin e denjë tuajin, jo vetëm në seria A, por në përgjithësi, Tare ka thënë se ka shumë, pasi gjenerata e re përfaqësohet nga shumë lojtarë që mund të arrijnë edhe më lartë. “Ka shumë, pasi gjenerata e re përfaqësohet nga shumë lojtarë që ndoshta do ta ngrënë edhe shumë më lartë emrin e Shqipërisë. Por unë do doja të përshëndesja në mënyrë të veçantë një bashkëlojtarin tim, Alban Bushin, trajneri e ekipit kombëtar të 21 vjeçarëve. Do kisha kënaqësinë ta ndaja me të këtë çmim”, ka deklaruar Tare.



Manaj vazhdon me formë të lartë

Rey Manaj shënon sërish, por Albacete shpërdoron një avantazh prej dy golash dhe në fund humbet mundësinë për t’u ngjitur përkohësisht në krye të Segunda Division. Minuta e 3-të po rezulton fatsjellëse për sulmuesin shqiptar që ashtu si ndaj Mallorcas një javë më parë edhe në sfidën e fundit ndaj Zaragozas realizoi pas vetëm 3 minutash lojë duke i dhënë avantazhin Albacetes. Manaj luaj-

ti një rol të rëndësishëm edhe në autogolin e Zaragozas në minutën e 20-të që i çoi shifrat në 2-0, megjithatë në pjesën e dytë miqtë shënuan dy herë duke i hequr fitoren nga duart Albacetes me ndeshjen që përfundoi në barazim 2-2. Manaj po kthehet në një lider të padiskutueshëm te skuadra e tij me Albaceten që pas 7 javësh nuk ka pësuar humbje dhe pozicionohet në vendin e 3-të të

Segunda Division në kuotën e 13 pikëve. Në 4 ndeshje vetëm tre prej tyre si titullar Manaj ka gjetur 3 herë rrugën e rrjetës ndërsa në total në këtë sezon me Albaceten numëron 4 gola pasi ka shënuar edhe në sfidën e Kupës së Mbretit ndaj Lugos. Manaj e ka nisur në mënyrë të shkëlqyer këtë sezon dhe ky është një sinjal i mirë edhe për trajnerin Panucci i cili beson shumë te ish lojtari i Interit.

Zi për shqiptarët e Amerikës, Gashi dhe Hyka po vuajnë shumë

Skuadra e Colorado Rapids që luan sulmuesi Shkëlzen Gashi është në garë me ekipin e Jahmir Hykës San Jose Earthquakes se kush bën më shumë humbje radhazi. Të dy ekipet ndajnë vendin e fundit dhe të parafundit me sulmuesin kosovar që është një shkalë më lart në renditjen e përgjithshëm. Java e fundit e kampionatit amerikan të futbollit nuk ndryshoi asgjë, pasi sërish të dy ekipet humbën. Ekipi Colorado Rapids u

sakatua në transfertë kundër Seattle me rezultatin 4-0. Lojtarit shqiptar nuk ishte i grumbulluar duke qenë një mungesë e madhe për ekipin amerikan. Gashi është dëmtuar dhe nuk ka qenë i gatshëm për trajnerin Anthony Hudson. 30-vjeçari ishte në formë të mirë, pasi shënoi gol në ndeshjen e kaluar, por nuk ia doli mbanë të ishte i pranishëm në fushë në sfidën e së sh-tunës. Rapids ka 6 humbje radhazi. Të njëjtën ecuri ka dhe Earthquakes

i Jahmir Hykës. “Tërmetet” e Amerikës kanë humbur sërish në transfertë kundër Houston Dynamo me rezultatin 3-2. Mesfushori shqiptar nuk e nisi takimin si titullar, por nga stoli. Ai u hodh në fushë në minutën e 59’ dhe pati një impakt negativ. Skuadra e tij po udhëhiqte 1-2 në momentin që 30-vjeçari u hodh në fushë, më pas rezultati u kthye në favor të vendasve 3-2. Përfundimisht një tjetër javë skandaloze për Gashin dhe Hykën.





City ofron 240 milionë euro për Mbappe

Sulmuesi francez Kylian Mbappe është gati të provojë lavdinë edhe në Premier League, madje që këtë sezon, duke mos pritur më shumë. Sipas të përditshmes britanike "Daily Mail" sulmuesi kampion bote mund të transferohet që në janar te kampionët e Manchester City, që janë gati të thejnë çdo rekord. City ofron 200 milionë sterlina për sulmuesin 19-vjeçar, për ta sjellë që në janar në Premier. Trajneri Pep Guardiola e kërkon me ngulm lojtarin që luan në League 1 me PSG-në, që sipas tij është i përshtatshëm për skuadrën e City dhe do ta ndihmonte atë për të shkruar së bashku historinë edhe në Champions League. Shuma prej 200 milionë sterlinash (240 milionë euro) është një rekord dhe mund të bindte të gjitha palët që ky transferim të realizohej sa më shpejt.

FERGUSON I SHPREH NDJENJAT PËR GJENDJEN AKTUALE NË UNITED



Manchester Unitedi ndodhet në pozitën e dhjetë në tabelën e Premierligës, gjithsej nëntë pikë pas Chelseat dhe Liverpoolit. Nga shtatë ndeshjet e zhvilluara, ata e kanë barazuar një, ndërsa i kanë humbur tri. Ferguson është rikthyer në Old Trafford për ndeshjen kundër Wolvesit për herë të parë që nga muaji maj, pas operacionit që pati për shkak të gjakderdhjes në tru. Para ndeshjes, ai kishte kërkuar nga ish-klubi i tij fitore, gjë që nuk kishte ndodhur. Media angleze Mirror raporton se Ferguson është mjaft i shqetësuar me gjendjen aktuale të klu-

Ish-trajneri legjendar i Manchester Unitedit, Sir Alex Ferguson, është i shqetësuar me situatën aktuale brenda klubit. Gjithashtu, problemet e fundit me mesfushorin francez, Paul Pogban, nuk e kanë habitur aspak skocezin

bin, si dhe në bisedë me disa shokë të tij, skocezi e ka cilësuar situatën në klubin si një cirk për shkak të gjithë publicitetit negativ. Kohët e fundit, problemit të rezultateve i është shtuar edhe problemi mes Pogbas dhe trajnerit Mourinhos. Të mërkurën e javës së kaluar, Sky Sports News e kishte publikuar një video nga seanca stërvitore në Carrington, ku shiheshin Pogba dhe Mourinho duke u fjalosur. Një ditë më parë ishte raportuar se Mourinho i kishte thënë Pogbas se kurrë më nuk do ta mbante shiritin e kapitenit për Manchester Unitedit,

pas kritikave që ia kishte bërë taktikave të portugezit publikisht. Pogba kishte thënë se ata duhet të sulmonin më shumë. Por, ky problem nuk e kishte habitur aspak Fergusonin, i cili beson se rikthimi i Pogbas në Manchester United për 105 milionë euro ishte një recetë për probleme dhe dështim. Skocezi kishte qenë trajner i Manchester Unitedit kur e kishte lejuar transferimin e Pogbas në Juventus pa paguar asnjë shumë parash. Problemi me Pogban, sipas Fergusonit, kishte qenë për shkak të agjentit të tij, Mino Raiolas.

Spalletti: Dalbert ka një të majtë si ajo e Roberto Carlos

Trajneri Luciano Spalletti i gëzohet fitores së tretë radhazi në kampionat. "I kënaqur, pasi pata mundësi të bëj disa zëvendësime dhe të aktivizoj forca të reja në fushë, që u përgjigjën mirë dhe korrëm një fitore të madhe", trajneri trajneri i ekipit zikaltër pas fitores 2-0 ndaj Cagliari. "Në ndonjë rast edhe bëme gabime në qarkullimin e topit, por në përgjithësi luajtëm mirë dhe morëm 3 pikë të rëndësishme, që na mbajnë në zonën Champions", tha Spalletti. Spalletti më pas ka përgëzuar edhe disa lojtarë në veçanti, si Dalbert, që sipas tij ka një të majtë të frimshme. "Është rritur shumë si lojtar dhe tifozët e kuptuan këtë gjë, duke e duartrokur. Ndaj Cagliari bëri një ndeshje të madhe, është i sh-



pejtë, lëviz shumë në fushë dhe ka një të majtë të fuqishme, njësoj si ajo e Roberto Carlos. Por ka nevojë për më shumë kualitet në lojën e tij", tha Spalletti, që përgëzon edhe Lautoro: "Është i fortë, ka kualitet e teknikë, por është pak egoist".

De Rossi e pranon se luan i lënduar që dy vite: Derbin e merituar ta fitojmë

Roma ka arritur ta fitojë ndeshjen më të rëndësishme të tyre në kampionat, atë ndaj Lazios. Giallorosët triumfuan me rezultat 3-1 në një ndeshje të shkëlqyer të tyre. E për këtë fitore ka folur edhe lideri i Romës, kapiteni Daniele De Rossi. Italiani ka zbuluar për herë të parë se luan me një problem fizik që prej dy viteve. "Unë kam një problem fizik që dy vite dhe nëse luaj shumë ndeshje radhazi më përsëritet dhe nuk më lë rehat. Por do të vazhdoj të jap maksimumin për këtë fanellë", tha De Rossi. Tutje italiani deklaroi pas ndeshjes se skuadra e tij e meritoi triumfin në derbi. "Kemi treguar se jemi një skuadër e bashkuar e përbërë nga njerëz të rëndësishëm. Derbi gjithmonë është shumë i vështirë, por nëse je i fortë atëherë nuk e ke problem ta fitosh, ne treguam se jemi të fortë dhe trium-



fuar", tha De Rossi. 35-vjeçari krejt në fund mbrojti shokët e tij të skuadrës nga kritikave e mëdha që morën. "Pellegrini është një djalë serioz dhe një romak. Romakët kritikant i lëndojnë dhe ai sot iu përgjigj më së miri kritikave. Edhe Fazio e Kolarov janë djem të shkëlqyer që treguan në fushë vlerat e tyre", përfundoi De Rossi.

ZYRTARE: BEPPE MAROTTA LARGOHET NGA JUVENTUSI

Drejtori i përgjithshëm, Beppe Marotta ka konfirmuar se do të largohet nga Juventus më 25 tetor, por jo për tu bërë president i Federatës Italiane të futbollit [FICC]



Rrugët për Juventus dhe Beppe Marotta janë ndarë. Administratori i deleguar i bardhezinjve në mënyrë krejt të papritur, fill pas fitores së rëndësishme të Juventus ndaj Napolit me rezultatin 3-1, ka dalë në një intervistë për "Sky Sport" për të njoftuar lamtumirën e tij nga "Zonja e Vjetër". "Mandati im në cilësinë e administratorit të deleguar do të skadojë në 25 tetor, klubi dhe aksionerët po punojnë mbi një politikë rinovimi. Në listën e kandidatëve të rinj nuk do të jetë më emri im. Do të qëndroj te Juventus si drejtor i përgjithshëm të pjesës sportive. Përgënjeshtroj në mënyrë kategorike se mund të jem kandidat për Ficc, për momentin është

një eksperiencë që nuk më përket", deklaroi Marotta, i cili më pas, i nervozuar nga pyetjet e gazetarëve bëri edhe pohimin më të bujshëm: "Po, rrugët tona ndahen!", duke lënë të kuptohet se edhe roli i tij i ri te Juventus është vetëm i përkohshëm.

Në aventurën e tij në Torino, Marotta ka fituar shtatë tituj kampion, katër Kupa të Italisë dhe tre Superkupa italiane. Vlerësimi më i fundit për atë në cilësinë e drejtuesit të Juventus, morriti vetëm javën e kaluar, kur Marotta fitoi çmimin

"The Best" për kategorinë ekzekutive, si menaxheri më i mirë i vitit. Njoftimi i tij i mbrëmjes së të shtunës, për tu larguar nga Torino, ndërsa në ditët në vijim do të mësohen padyshim motivet e këtij divorci mes Marotta dhe Juventus.



Sarri: Në fund të sezonit 4-5 lojtarë të Chelsea do kenë realizuar mbi 10 gola

Trajneri Maurizio Sarri ka mbetur i kënaqur nga loja e skuadrës së tij në barazimin 1-1 që Chelsea arriti në "Stamford Bridge" ndaj Liverpool edhe pse "blutë" e Londrës mund të kishin marrë një fitore, duke qenë se goli i miqve u realizua 2 minuta nga fundi. "Mendoj se për atë që u pa në fushë, barazimi ishte rezultati më i drejtë. Jam i kënaqur për mënyrën se si skuadra ime u paraqit në këtë sfidë, që ishte ndryshe nga ajo e Kupës. Sidomos në aspektin mbrojtës, ku po bëjmë mjaft përmirësime", u shpreh Sarri. Edhe një herë, ishte belgu Eden Hazard ai që bëri diferencën në fushë për Chelsea, duke realizuar golin e parë dhe më pas erdhi barazimi i Sturridge, me një gol fantastik nga jashtë zone. "Po përmirësohemi shumë, në të gjithë sektorët dhe mendoj se në fund të sezonit do të kemi 4-5 lojtarë që do të kenë realizua mbi 10 gola, jo vetëm Hazard. Ai mund të jetë i pari që do të ketë arritur këtë shifër, por edhe Pedro, Willian, Morata e ndonjë tjetër mund të rrijnë këtë kuotë", tha Sarri.

Pogba nuk ka respekt për askënd, meriton të largohet që në janar

Edhe pse popullariteti i trajnerit Jose Mourinho ka rënë ndjeshëm kohët e fundit, sidomos pas humbjes 3-1 që United pësoi ndaj West Ham, sërish trajneri portugez gëzon besimin e mjaft ikonave të skuadrës së Manchester United. Njëri prej tyre, Paul Ince, në një intervistë për "The Sun", ka mbrojtur vendimet e marra nga trajneri, duke thubtuar e kritikuar Pogba për sjelljen e tij në fushë e jashtë saj: "Kjo është një situatë e shëmtuar, e cila ka kohë që po përsëritet". "Polemikat që kanë nisur mes Mourinho e Pogba pas Botërorit po shkatër-

rojnë të gjithë ekipin, që e ndjen këtë tension dhe nuk arrin të japë atë që duhet. Situata po degjeneron dhe klubi rrezikon të dështojë edhe këtë sezon. Ndaj, mendoj se është më mirë për të gjithë që Pogba të shitet që në janar", tha më tej Paul Ince. Më tej, Ince tha: "Pogba duhet të tregojë më shumë respekt për trajnerin dhe mbi të gjitha karshi skuadrës. Në kohët e mia, një situatë e tillë nuk do të ndodhte apo tolerohej. Ndaj klubi duhet të ndërhyjë dhe jo të qëndrojë indiferent", tha "Gubernurori", siç dhe njihet ndryshe Ince.



Kovac: Të ruajmë qetësinë, një humbje nuk është fundi i botës

"Humbja e parë e Bayern do të vinte herët a vonë, ndaj pas 7 fitoresh radhazi nuk kemi se përse të shqetësohemi", ka deklaruar sot trajneri Niko Kovac, pas humbjes 0-2 që kampionët e Bundesligës pësuan nga Hertha Berlin në kampionat. Trajneri kërkon të evitohet panikun, sidomos tani që në krye të renditjes ndodhet Borussia Dortmund.

Por një barazim dhe një humbje brenda pak ditësh nuk janë një sinjal pozitiv për skuadrën e Bayern Mynih, që përgatitet për sfidën e radhës në Champions League ndaj Ajax. "Nuk nuk arritëm të shfrytëzojmë si duhet shanset që na u krijuan. Të dyja golat që pësuaam ndaj Herdha ishin të evitueshëm, ndodhën edhe për fajin tonë. Gabimet ndodhin

gjithnjë dhe ndëshkohesh nëse rivalët përfitojnë nga to. Pavarësisht kësaj, kemi zhvilluar ndeshje të mira edhe pse në dy ndeshjet e fundit kemi bërë disa gabime taktike në fushë. Ne jemi Bayern dhe do të rikthehemi te fitorja dhe gjërat do të qetësohen sërish. Luajmë çdo 3 ditë, ndaj kemi shansin për t'u ringritur dhe treguar se kush jemi", tha Kovac.



VUÇIQ I KËRKON NDIHMË PUTINIT PËR SITUATËN NË KOSOVË

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq e cilësoi "sulm të armatosur banditësh" hyrjen e forcave speciale të Kosovës, ROSU të shtunën në veri të Kosovës. Sipas Vuçiqit me hyrjen e tyre në këtë territor u kërcënua paqja



Vizita e së shtunës e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në pjesën veriore të vendit, ka alarmuar presidentin serb, Aleksandar Vuçiq. Vuçiq për zhvillimet e fundit në Kosovë, ka thënë se do të kërkojë ndihmën e Ruisë. "E kemi njoftuar ambasadorin rus, sikurse atë të SHBA-së dhe të tjerët për situatën. Brenda dy ditësh, do të takohem me Presidentin Putin dhe do të flasë për të për të gjitha çështjet me rëndësi", ka thënë Vuçiq. "Natyrisht, situata në Kosovë dhe Metohi do të jetë prioritet", ka thënë ai.

"Do ta informoj Putin për zhvillimet e fundit dhe do t'i kërkojë mbështetje në të gjitha forumet ndërkombëtare. Padyshim se do t'i kërkojmë këshilla". Dje Vuçiq, pasi vizitës së Thaçit në Ujman dhe pikën kufitare në Bërnjak, ka ftuar

ushtrinë serbe që të jetë në gjendje gatishmërie. Ndërkohë, bëhet e ditur se Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq do të takohet më 2 tetor në Kremlin me presidentin rus Vladimir Putin. Temat e diskutimit nuk janë bërë të ditura. Sipas njoftimeve të Kremlinit, Putini dhe Vuçiq nuk do t'u drejtohen gazetarëve pas bisedimeve. Vuçiq u takua me Putinin për herë të fundit gjatë një vizite dy-ditore në Moskë në maj, kur ai mori pjesë në Paradë Ushtarake. Ambasadori i Ruisë në Serbi, Aleksander Chepurin, nënvizoi në takimi me Vuçiqin në tetor do të mbahet në një periudhë të rëndësishme të politikës së jashtme për Serbinë dhe Rusinë.

"Veprimi ynë i përbashkët është vetëm pozitiv, ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve të ven-

deve tona që hyjnë në fazën e trazirave ekonomike dhe ringjalljes kombëtare", tha Chepurin.

Ai theksoi se takimi ndërmjet Vuçiqit dhe Putinit konfirmon marrëdhëniet e mira personale dhe respektin e ndërsjellë të dy presidentëve. "Marrëdhëniet tona të veçanta nuk janë pengesa për zhvillimin e marrëdhënieve me vendet e treta, për shembull Serbia me BE, përkundrazi", ka thënë ambasadori i Ruisë. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq e cilësoi "sulm të armatosur banditësh" hyrjen e forcave speciale të Kosovës, ROSU të shtunën në veri të Kosovës. Sipas Vuçiqit me hyrjen e tyre në këtë territor u kërcënua paqja.

"Operacioni përfshiu 110 deri në 130 anëtarë të forcave speciale të Kosovës, të gjithë shqiptarë, që kanë zënë rrugë hyrëse dhe të

gjitha objektet pranë Ujmanit, duke keqtrajtuar brutalisht disa persona dhe duke mbajtur peng katër", tha Vuçiq për mediat serbe. Kujtojmë se njësitet speciale të Kosovës të shumta në numër në veri ishin për shkak të vizitës së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dje në vendkalimin kufitar Bërnjak dhe Liqenin e Ujmanit.

Thaçi pohoi se vizita e tij atje ishte "rutinore" dhe "krejt normale", por autoritetet në Serbi thanë se Policia e Kosovës ka marrë nën kontroll Liqenin dhe hidrocentralin e Ujmanit dhe se ka arrestuar disa serbë. Vuçiq, në një fjalim drejtuar kombit serb, tha se me vizitën e Thaçit u shkelën disa marrëveshje. "Nuk e di nëse kanë pasur pëlqimin e NATO-s, por kushti i dytë është shkelur plotësisht", tha presidenti serb.

ISH-ZËVENDËS SHEFI I CIA



SHBA-të nuk do ta kundërshtojnë ndryshimin e kufijve

Ish-zëvendës shefi i CIA për Ballkanin, Stephen Meyer, po konsideron se Amerika do ta pranonte një ndryshim të mundshëm kufijsh në Ballkan. Në një intervistë për gazetën serbe "Novosti", Meyer ka thënë se Ballkani tashmë është në një udhëkryq, dhe se liderët e saj duhet të sillen si të tillë, e jo si subjekte të shteteve të Perëndimit, transmeton lajmi.net.

"Politika e SHBA-ve e ka rikthyer vëmendjen në Lindjen e Mesme, Rusinë dhe Ballkanin, vende këto që nuk përbënin prioritet në vitet e 90-të. Ndonëse, pjesa më e madhe e politikës ndaj Ballkanit qëndron në një çështje të inercionit nga e kaluara, dhe tani administrata e re thotë se është në dorën tuaj të vendosni, kjo është një mundësi e mirë për ju liderë", shprehet Meyer. Sipas Meyer, megjithëse SHBA-të nuk do ta kundërshtojnë një ndryshim të mundshëm kufijsh, këtë do ta bënte Gjermania, e cila sipas tij i frikësohet kësaj destabilizimit. "Problemi është në Departamentin e Shtetit, diplomatët që punojnë në atë regjon për vite e kanë vendosur një vijë zyrtare. Por ajo po ndryshon tani. Nuk besoj që nese lider-shipi këtu do të dëshironte një ndryshim kufijsh, Ëashingtoni do ta kundërshtonte atë.

Megjithatë Gjermania do ta bënte, sepse i frikësohet jostabilitetit", ka thënë ai. Sipas tij, Britania është ende e pavendosur për një ide të tillë. Meyer shton se edhe Bashkimi Evropian do ta pranonte një zgjidhje të tillë nëse do të arrihej në mënyrë paqësore. Sipas tij, bisedimet e Thaçit me Vuçiq për demarkacion mes dy vendeve, nënkuptojnë ndryshim kufijsh. Meyer thotë se një proces i tillë do të përcillet edhe me kërkesën e kroatëve të Bosnjës për tu bashkëngjitur me Kroacinë, ku një referendum është i nevojshëm. Theksojmë se ashpër kundër ndryshimit të kufijve në Ballkan tashmë ka dalur vetëm Gjermania, ndërkaj që SHBA mbështet një zgjidhje paqësore mes dy vendeve.

SHBA dhe BE përkrahin shkëmbimin territorial Kosovë-Serbi

Liderët e SHBA-së dhe Bashkimit Evropian janë konvergjent që t'i japin përkrahje planit që Kosova dhe Serbia t'i vënë kufijtë e tyre përgjatë vijave etnike – projekt të cilin e kundërshton Gjermania. Kështu thuhet në një dokument që ka parë "The Wall Street Journal", i hartuar nga shërbimi i jashtëm i BE-së në të cilën shfaqet mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së vjetër mes Kosovës dhe Serbisë e ku organi ekzekutiv i BE-së ka miratuar argumentet e Washingtonit dhe ka refuzuar ato të Gjermanisë, përcjell Klan Kosova. Derisa marrëveshja thekson se Evropa dhe SHBA vazhdojnë të punojnë ngushtë në iniciativën e politikës së jashtme që prej rajonin, një çarje e Gjermanisë poashtu shfaq vullnetin e Washingtonit për të injoruar kundërshtimet e fuqisë më të madhe në kontinentin evropian.



Në dokument thuhet se BE shpreh përkrahjen e një plani të përbashkët Kosovë-Serbi, përkrahur nga administrata e Presidentit të SHBA-së, Donald Trump, që të ricaktohen kufijtë në Evropën Juglindore si mënyrë e sigurimit të

plotë të shtetësisë së vendit të vogël dhe të izoluar, Kosovës. Në rast të dyshimit të këtij plani thuhet se vendim me dy milionë banorë mund të rrëshqas në kriminalitet, konflikte dhe ekstremizëm islamik. Në anën tjetër

krerët e Gjermanisë, kundërshtojnë shkëmbimin e territoreve duke iu frikësuar nxitjes së separatizmit në baza etnike sikurse në vende, Bosnjë dhe Maqedoni, e prej ku mund të rridhte konflikt në rajon.

“Kam qenë me të vërtet shumë i ashpër, sikurse edhe ai. Patëm avancimet tona dhe tërheqje gjithashtu”, tha Trumpi përpara turmës në Virxhinian Perëndimore. “Por më pas ne ramë në dashuri. Ai më ka shkruar letra të bukura dhe shumë cilësore”, tha më tej ai

UNË E KIM JONG-UNI KEMI RËNË NË DASHURI



Presidenti amerikan Donald Trump e ngriti entuziazmin e tij për uljen e tensioneve me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong-un, në lartësi të reja gjatë së sh-tunës, teksa deklaroi përpara një turme mbështetësish se të dy ata “kanë rënë në dashuri” pas këmbimit të letrave kohët e fundit.

Trump dhe Kim janë deklaruar prej kohësh tashmë se duan të punojnë drejt denuklearizimit të gadishullit të Koresë, që pas mbajtjes së një samiti të paprecedentë më herët gjatë vitit në Singapor. Përpara se të kthenin faqet e një acarimi publik disa dekadësh, udhëheqësit e të dyja vendeve shkëmbyen rregullisht kërcënime dhe ofendime, ndërkohë që Koreja e Veriut vijonte përpjekjet e saj për të zhvilluar një raketë bërthamore të aftë për të goditur Shtetet e Ba-

shkuara, shkruan Tch.

“Kam qenë me të vërtet shumë i ashpër, sikurse edhe ai. Patëm avancimet tona dhe tërheqje gjithashtu”, tha Trumpi përpara turmës në Virxhinian Perëndimore. “Por më pas ne ramë në dashuri. Ai më ka shkruar letra të bukura dhe shumë cilësore”, tha më tej ai. E teksa ai shprehej me këto fjalë, mbështetësit e tij shpërthyen në të qeshura dhe duartrokitje. Trump vijoi më tej duke thënë se

disa analistë do ta quanin atë si aspak “presidencial” teksa e përkrahente Kimin me të tilla terma. Administrata e Trumpit, ndërkohë, po përgatitet për një samit të dytë me Kim Jong-unin për të diskutuar mbi denuklearizimin. Por, koha dhe vendi i takimit nuk janë përcaktuar ende. Pavarësisht toneve më të zbutura mes dy palëve, Koreja e Veriut thuhet se nuk iu është përmbajtur kërkesave të Amerikës për të ofruar një

inventar të plotë të programeve të armëve dhe për të ndërmarrë hapa të pakthyeshëm për dorëzimin e arsenalit të saj bërthamor. Tre zyrtarë të lartë amerikanë të përfshirë në politikën ndaj Koresë së Veriut thanë gjatë javës se nuk është bërë aspak progres drejt negociatave serioze mbi eliminimin, apo ndalimin e programeve të armëve bërthamore apo raketave balistike të Kim Jong-unit.



“Lojëra politike” për marrëveshjen me BE

Kryeministrja britanike, Theresa May, ka akuzuar deputetët që refuzojnë ta mbështesin marrëveshjen tregtare pas Brexit-it me Bashkimin Evropian, që po bëjnë “lojë politike” me të ardhmen e Britanisë. Ish sekretari i Jashtëm, Boris Johnson, reagoi ndaj këtij plani duke e quajtur të çmendur. Por, May deklaroi për media se ishte e vetmja strategji e mundshme, përkundër refuzimit nga BE. May shtoi se ka në plan të shtojë taksat ndaj shtetasve të huaj që jetojnë në Britani. Ajo theksoi se plani që BE-ja dhe Britania të bashkëpunojnë për tregti, por jo ofrim të shërbimeve, është mënyra e vetme kredibile për të mënjanuar një kufi mes Irlandës veriore dhe Republikës Irlandeze. Kjo strategji është kritikuar mjaft nga konservativët, që theksojnë se kjo marrëveshje mund të rrezikonte sovranitetin e vendit dhe të tradhtonte votën e vitit 2016.

Indonezi, fshatra të tërë të zhdukur nga tërmeti dhe cunami

Ka shkuar mbi 800 persona bilanci i të vdekurve nga tërmeti dhe cunami që të premten 28 shtator ka goditur pjesën qendrore të ishullit indonezian të Sulawesi. Lajmin e ka bërë të ditur zëdhënësi i mbrojtjes civile. Forcat zjarrfikëse vazhdojnë të kërkojnë për të mbijetuar. Tërmeti ka shkatërruar shembjen e shumë ndërtesave, ndërsa Cunami ka zhdukur gjithçka ka gjetur përpara.



Në brigje kanë mbërritur kuformat të cilat besohet se do të jenë më të shumta me kalimin e orëve.

Pavarësisht ndihmës, autoritetet kanë ngadalësuar operacionet e shpëtimit edhe për shkak të infra-

strukturës plotësisht të dëmtuar dhe në disa zona ku jetojnë rreth 600 mijë njerëz, forcat e shpëtimit

nuk kanë mundur ende të hyjnë. Në Palu, në kryeqytetin e provincës, balta është bashkuar me mbetjet e shtëpive të shkatërruara, të cilat së bashku me ujin morën përpara gjithçka pas tërmetit.

Vetëm dy nga shtatë centralet e zonës janë ende në funksion. Energjia elektrike, uji dhe telekomunikacioni janë të gjitha jashtë funksionit. Qindra trupa janë mbuluar me çarçafëve përgjatë rrugës, ndërsa të plagosurit po mjekohen në shtretër të improvizuar jashtë, sepse të gjitha spitalet e zonës janë

shkatërruar plotësisht. Nevoja për shtretër, ilaçe mjekësore, ushqime është shumë e madhe.

Të gjitha viktimat janë nga qyteti Palu. Banorët e Palu, në bregun perëndimor të Celebes, janë rreth 350 000. Shqetësuese mbetet situata në Donggala, më në veri. Shefi i mbrojtjes civile Muhammad Syaugi, ka treguar që vetë ai ka dëgjuar të thirrura për ndihmë poshtë gërmadhave në një hotel tetë katësh në Palu, Roa-Roa. Aty mund të jetë të bllokuar rreth 50 veta.

Publicitet

UNIVERSITETI “SHËN KIRILI DHE METODI”
FAKULTETI FILOLOGJIK • BILLAZE KONESKI • SHKUP

Bul. Kote Mairkov pa 1000 Shkup, R. Maqedonia
 Dekanat: +389 2 3240 401, Qendra: +389 2 3240 400
 Faks: +389 2 3223-811

Nr. _____
 Shkup

Në bazë të nenit 172 paragrafi 1 dhe nenit 175 paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82 e 8 maj 2018), nenit 48 paragrafi 1 pika 25 e Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe punës së Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe nenit 34 paragrafi 1 nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe titujt bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, të publikuar në Fletën universitare nr. 274 (Tekst i pastruar), Këshilli i mësimor-shkencor i Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, publikon

KONKURS
 Për zgjedhje në titullin bashkëpunues

- Dy asistentë të lëndës Gjuha bashkëkohore maqedonase

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme me Ligjin për arsim të lartë të RM dhe Rregulloren për kriteret e vetme dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Fletëparaqitjet, shtojcat (biografi, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, realizime pedagogjike dhe të tjera nga fillimi i karrierës e deri në ditën e paraqitjes), dëshmitë se kandidatët kanë arritur shkallën e caktuar shkencore magjistër, gjejmësisht doktor të shkencave filologjike, nga fusha shkencore për të cilën zgjidhen, dërgohen në 4 (katër) kopje në Arkivin e Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup, në afat prej 8 ditëve nga publikimi i Konkursit.

Përveç asaj kandidatët duhet të dorëzojnë edhe nga një kopje të punimeve shkencore dhe profesionale.

Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Orari i punës do të jetë në ndërrim të parë, prej ora 8 deri në ora 16, ndërsa neto pagesa fillestare për një asistent do të jetë 25.540,00 denarë.

Fillimi, përfundimi dhe orari i punës dhe shuma në të holla e pagesës bazë për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin zgjidhet mësimdhënësi.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh për shqyrtim.

DEKAN
 i Fakultetit filologjik
 Prof. Dr. Aneta Duçevska

UNIVERSITETI “SHËN KIRILI DHE METODI”
FAKULTETI FILOLOGJIK • BILLAZE KONESKI • SHKUP

Bul. Kote Mairkov pa 1000 Shkup, R. Maqedonia
 Dekanat: +389 2 3240 401, Qendra: +389 2 3240 400
 Faks: +389 2 3223-811

Nr. _____
 Shkup

Në bazë të nenit 172 paragrafi 1 dhe nenit 176 paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82 e 8 maj 2018), nenit 48 paragrafi 1 pika 25 e Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe punës së Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe nenit 34 paragrafi 1 nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe titujt bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, të publikuar në Fletën universitare nr. 274 (Tekst i pastruar), Këshilli i mësimor-shkencor i Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, publikon

KONKURS
 Për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor

- Një mësimdhënës (në të gjitha titujt) në sferën mësimore-shkencore Historia e letërsisë së popujve gjerman

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme me Ligjin për arsim të lartë të RM dhe Rregulloren për kriteret e vetme dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Fletëparaqitjet, shtojcat (biografi, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, realizime pedagogjike dhe të tjera nga fillimi i karrierës e deri në ditën e paraqitjes), dëshmitë se kandidatët kanë arritur shkallën e caktuar shkencore magjistër, gjejmësisht doktor të shkencave filologjike, nga fusha shkencore për të cilën zgjidhen, dërgohen në 4 (katër) kopje në Arkivin e Fakultetit filologjik “Bilazhe Koneski” në Shkup, në afat prej 8 ditëve nga publikimi i Konkursit.

Përveç asaj kandidatët duhet të dorëzojnë edhe nga një kopje të punimeve shkencore dhe profesionale.

Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Orari i punës do të jetë në ndërrim të parë, prej ora 8 deri në ora 16, ndërsa neto pagesa fillestare për një mësimdhënës (në të gjitha titujt) do të jetë 30.869,45 denarë.

Fillimi, përfundimi dhe orari i punës dhe shuma në të holla e pagesës bazë për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin zgjidhet mësimdhënësi.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh për shqyrtim.

DEKAN
 i Fakultetit filologjik
 Prof. Dr. Aneta Duçevska

Pas vitesh të tëra në gjyq për krime lufte, deputeti kroat Branimir Glavas ka vazhduar të përfitojë nga rrethanat e favorshme që e kanë mbajtur atë jashtë gjyqit dhe kanë ruajtur statusin e tij si lojtar politik

“Unë jam absolutisht për gjykimin e krimeve të luftës, pa marrë parasysh se në cilën palë u kryen ato,” tha deputeti kroat Branimir Glavas të hënën për N1TV, kur u pyet për një protestë të planifikuar në Vukovar, që thuhet se u shkaktua nga mungesa e ndjekjeve penale të krimeve të luftës kundër kroatëve të kryera në qytet në vitin 1991.

Deklarata të tilla janë pothuajse një klishe në rajonin e ish-Jugosllavisë, por ato funksionojnë për mrekulli. Pasi ai përdori këtë frazë, askush nuk mund ta akuzonte Glavas, një i pandehur prej shumë kohësh për krime lufte, për mosrespektim të sundimit të ligjit.

Në intervistën e tij me N1 TV, Glavas gjithashtu u përpoq të mbron kryeministrin Andrej Plenković, i cili thuhet se është shënjestra e një komploti “grushti shteti” të krahut të djathtë brenda Partisë Bashkimi Demokratik Kroat, HDZ. Glavas pretendoi se protesta e planifikuar është politikisht e motivuar dhe nuk kishte lidhje me krimet e luftës dhe po organizohet nga deputeti Milijan Brkić, i cili besohet të jetë kundërshtari i Plenkovićit brenda HDZ-së.

Në muajt e fundit, me një shumicë të vogël në parlament, Plenković praktikisht varej nga votimi i Glavasit. Glavas, i cili ka partinë e tij politike dhe e portretizon veten si konservator, e mbështeti Plenkovićin gjatë një votimi parlamentar mbi miratimin ose jo të Konventës së Stambollit të Këshillit të Europës, që synon të trajtojë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje - një lëvizje që u kundërshtua fort nga e djathta. Katërmëdhjetë deputetë të HDZ votuan kundër, por Glavas dha mbështetjen e tij.

Para se dikush të fillojë të mendojë se Glavas është kalorësi i Plenkovićit me parzmore të shndritshme, një luftëtar trim për vlerat liberale kundër radikalëve të krahut të djathtë, ata duhet të mësojnë disa nga gjërat e tjera që ai ka thënë gjatë viteve, si edhe me gjërat për të cilat ai akuzohet ende se ka kryer.

Vlen gjithashtu të theksohet se jo vetëm që ka arritur të shmangë dënimin për krimet e tij të dyshuara që prej vitit 2006 - kur ai u arrestua për herë të parë - por gjithashtu ka arritur të ketë një karrierë të gjatë politike dhe të jetë pjesë e shumicës qeverisëse në parlament. Ndryshe nga viktimat e tij të dyshuara, të vdekura prej pothuajse 27 vjetësh, Glavas ka mbijetuar.

BRANIMIR GLAVAS

I AKUZUARI MË FATLUM

KROAT PËR KRIME LUFTË



TORTURË ME ACID BATERIE

“Kjo qeveri është shkaku i gjithë mjerimit dhe zhgënjimit, ne kemi nevojë për një shtysë të re, të rikarikojmë bateritë, të jemi gati për sfida dhe luftë,” tha Glavas në shkurt të vitit 2015 në qytetin lindor kroat të Osijekut pasi u lirua nga burgu. Ai kishte vuajtur një dënim me burg për urdhërimin e ekzekutimit të 7 civilëve serbë të Kroacisë në Osijek në 1991, si komandant i forcave të mbrojtjes të qytetit. Gjykata vërtetoi se ai krijoi dhe armatosi një njësi speciale e njohur me shumë emra - Trupa Mbrojtëse ose Batalioni i Osijekut i Branimit - dhe veprroi si komandant i saj efektiv. Ajo që e bën deklaratën e Glavas pas lirimit të tij më interesante është mënyra në të cilën disa prej viktimave u torturuan përpara



se të vriteshin. Në çështjen e koduar me emrin “Garazhi”, e emërtuar sipas vendit në të cilin të burgosurit mbaheshin dhe torturoheshin, gjykata konstatoi se

një burrë i quajtur Cedomir Vučković u detyrua të pinte acidin nga një bateri makine. Pas pirjes së acidit, Vučković, me dhimbje të paimagjineshme, doli nga garazhi që më

pas të qëllonjë me armë nga Krunoslav Fehir, një nga njerëzit e Glavasit. Në këtë kuptim, shprehja e çuditshme e Glavasit në fjalimin e tij të kthimit në shtëpi ishte simptomatike. Ai përdori fjalën ‘akumulator’ - në kroatisht për bateri makine.

NDËRPRERJE TË PËRSËRITURA TË DREJTËSISË

Është gjithashtu e rëndësishme të dihet se Glavas nuk u lirua nga burgu sepse ai u gjet i pafajshëm. Në janar të vitit 2015, në mes të një sage ligjore të komplikuar, Gjykata Kushtetuese Kroate anuloi vendimin e tij përfundimtar të dhënë nga Gjykata e Lartë në vitin 2010. Gjykata Kushtetuese nuk pretendoi se Glavas nuk ishte fajtor, por e anuloi vendimin për shkak se në gjyqin e tij ishte përdorur protokoll i gabuar nga Konventat e Gjenevës. Në korrik 2016, Gjykata e Lartë rrezoi vendimin e shkallës së parë të dhënë nga gjykata e qarkut të Zagrebit në vitin 2009 për të njëjtën arsye. Gjyqi i Glavasit më pas rifilloi përsëri përpara gjykatës së qarkut të Zagrebit në tetor 2017. Që nga ditët e para të gjyqimit të tij, Glavas kërkoi të pengonte procedurat. Në vitin 2006, kur u arrestua për herë të parë, ai nisi një grevë urie 37-ditore. Kjo e ndërpreu hetimin për çështjen e ashtuquajtur “Sellotape” kundër tij dhe e nxori atë nga paraburgimi.

Në rastin “Sellotape”, njësia e Glavasit arrestoi gjashtë civilë në nëntor dhe dhjetor 1991 dhe pastaj i torturoi në një bodrum në Osijek. Ata më pas u çuan në bregun e lumit të Drava, ku anëtarët e njësive të ekzekutuan, me duart e lidhura pas shpine me shirit ngjitës.

Në vitin 2007, Zyra e Prokurorit të Shtetit paraqiti një padi për çështjen “Sellotape”, duke e futur Glavas në paraburgim. Ai pastaj filloi një tjetër grevë urie, këtë herë për 24 ditë.

Kur më vonë atë vit filloi gjyqi i tij para gjykatës së qarkut të Zagrebit, ai hyri në grevë urie për herë të tretë - këtë herë për 65 ditë.

Duke qenë se ai në atë kohë ishte deputet, parlamenti u desh t'i hiqte atij imunitetin. Megjithatë, në ato që disa mund t'i quajmë “akrobaci ligjore”, parlamenti thjesht i hoqi imunitetin, në mënyrë që ai të gjykohej, dhe nuk e futi atë në





paraburgim siç ndodh me shumicën e të dyshuarve për krime lufte, duke e lënë atë të lirë. Gjatë gjykimit, ai publikoi në internet emrin e një prej viktimave, identiteti i të cilit mbrohej nga gjykata, për të cilën ai nuk u gjykua kurrë, pavarësisht faktit se u paraqitën kallëzime penale. Ditën kur vendimi për të u lexua përpara gjykatës së qarkut të Zagrebit, duke e dënuar atë me dhjetë vjet burg, ai që në gjendje të ikte në Bosnjën dhe Hercegovinën fqinjë sepse nuk ndodhej në paraburgim. Duke qenë se ai mban dy nënshtetësi, kjo pengoi mundësinë e ekstradimit. Megjithatë, pasi Gjykata e Lartë konfirmoi vendimin - duke e ulur dënimin në tetë vjet - gjykata shtetërore e Bosnjës e konfirmoi vendimin, duke e dërguar atë në burg në Zenica dhe pastaj në Mostar.

NJË MBIJETESË POLITIKE SHUMËVJEÇARE

Edhe pse mediat kishin raportuar për krimet e tij të dyshuara për vite me radhë, hetimi dhe ndjekja penale e Glavasit filloi vetëm kur ai u konfliktua me kryetarin e HDZ, kryeministrin e atëhershëm Ivo Sanader, në 2005. Glavas nisi një rebelim të anëtarëve të HDZ nga Kroacia lindore kundër lidhshimit të partisë, dhe Sanaderi e dëboi atë. Glavas më pas i mbledhi rebelët rreth vetes dhe krijoi vetë një parti, Aleancën Demokratike Kroate të Sllavonisë dhe Baranjës, HDSSB. Ndërsa ndjekja e tij penale përkoji me ndarjen e tij politike me Sanaderin dhe HDZ-në, ai e përdori situatën në favor të tij, duke e paraqitur veten si viktimë e një gjyqi të motivuar politikisht. Kur partia HDSSB u shpërbë, Glavas edhe një herë gjeti një mënyrë për të mbijetuar politikisht. Ai u bashkua me shumicën qeverisëse të HDZ-së në

parlament, gjë e cila i dha më shumë pushtet politik sesa thjeshtë ishte deputeti i vetëm i HDSSB në një parlament prej 151 deputetësh. Ndërkohë HDZ kishte nevojë për mbështetjen e tij për të fituar vota në legjislaturë pasi u nda me partnerin e vogël të koalicionit, Ura e Listave të Pavarura, MOST. Kjo ndodhi kur pati një tjetër ngjarje me leverdi. Pas disa seancave në rigjykimin e tij përpara gjykatës së qarkut të Zagrebit, gjykata vendosi në mars të këtij viti ta ndajë çështjen e Glavasit nga ajo e pesë prej vartësve të tij të cilët po gjykohej bashkë me të. Pa dyshim, gjykata argumentoi se kjo ishte sepse të dy protokollet e Konventave të Gjenevës duhet të zbatoheshin në rastin e Glavasit dhe vetëm një nga protokollet në rastin kundër pesë vartësve të tij. Ndonëse kjo mund të ngajë si një çështje ekskluzivisht procedurale, ajo do të rezultojë në heqjen nga dosja e çështjes së Glavasit deklaratat në të cilat vartësit e tij e akuzojnë atë për krimet. Vartësit e Glavasit do të shfaqen në gjyqin e tij si dëshmitarë dhe jo si bashkë-autorë dhe do të kenë mundësinë të ndryshojnë dëshmitë e tyre.

Ndërkohë që protokollet e Konventave të Gjenevës u krijuan për të mbrojtur viktimat, në këtë rast, ato po mbrojnë mirë autorin e dyshuar. Për më tepër, gjykata vendosi në qershor të këtij viti të heqë dëshminë e dhënë nga Krunoslav Fehir nga dosja e çështjes Glavas - prova kryesore kundër tij - duke pretenduar se ishte e paligjshme. Por OJQ-ja në Zagreb Documenta - Qendra për Ballafaqimin me të Kalluarën, e cila ka ndjekur nga afër çështjen për vite me radhë, vuri në dukje se Gjykata e Lartë vendosi dy vjet më parë se provat nuk ishin të paligjshme. Ky ishte një tjetër zhvillim i leverdisshëm për Glavasit. Documenta pohoi se duke refuzuar këtë provë, si edhe duke ndarë rastet, gjykata po pastronte rrugën për të liru Glavasit.

Nëse kjo ditë fatkeqë vjen, Glavas nuk do të jetë vetëm një burrë i lirë, por do të shihet gjithashtu si viktimë e një gjyqi të padrejtë dhe të motivuar politikisht. Ai do të hyjë në histori si një politikan i moderuar, një luftëtar kundër radikalëve të ekstremit të djathtë dhe një njeri që u përpoq të ndërtonte një demokraci të shëndetshme kroate. Dhe kjo do të ishte vërtet shumë me leverdi për të. (BIRN)

LUFTA E DYTË. Gënjeshtër që hapi frontin e lindjes

Marshimi filloi me një gënjeshtër, nuk bëhej fjalë për një sulm për vetëmbrojtje të ushtrisë gjermane, por për një sulm ndaj vendeve dhe njerëzve të papërgatitur, për një shkelje të së drejtës ndërkombëtare, fillimin e një lufte shfarosëse me trupa brutale dhe gjenocid. Në fuqi ishte ende pakti gjermano-rus i mos-sulmimit, i arritur gati dy vjet më parë. Megjithatë më 22 qershor 1941, 3 milionë ushtarë të Wehrmacht-it u futën në marshim me gjithçka që ofronte industria nacional-socialiste e armatimit

Për zhvillimin e luftës kundër ish-Bashkimit Sovjetik, udhëheqja nacional-socialiste pati filluar përgatitjet që në vitin 1933 dhe tetë vjet më vonë, më 22 qershor 1941, një ushtri milionash marshoi në drejtim të Evropës Lindore duke filluar luftën me brutale që kishte përjetuar historia e re. Lufta filloi me një gënjeshtër propagandistike. Komunikata që u lexua në radio ishte: "Komando e lartë e ushtrisë njofton se në mbrojtje kundër rrezikut të madh që vjen prej lindjes, ushtria gjermane u ndesh më 22 qershor, në orën 3 të mëngjesit, me një dislokim të madh të forcave të armikut. Njësisia e forcave ajrore gjermane u ndesh në agim të ditës me armikun sovjetik".

Marshimi filloi me një gënjeshtër, nuk bëhej fjalë për një sulm për vetëmbrojtje të ushtrisë gjermane, por për një sulm ndaj vendeve dhe njerëzve të papërgatitur, për një shkelje të së drejtës ndërkombëtare, fillimin e një lufte shfarosëse, me trupa brutale dhe gjenocid. Në fuqi ishte ende pakti gjermano-rus i mos-sulmimit, i arritur gati dy vjet më parë. Megjithatë më 22 qershor 1941, 3 milionë ushtarë të Wehrmacht-it u futën në marshim me gjithçka që ofronte industria nacional-socialiste e armatimit: me tanke, aeroplanë, armë. Brenda natës, Bashkimi Sovjetik filloi luftën për mbijetesë. Legjenda, sipas të cilës Hitleri filloi më parë se Stalini marshimin, ndërkohë që edhe Ushtria e Kuqe kishte plane për një të tillë, ka jetuar për një kohë të gjatë. Megjithatë ajo nuk është vërtetuar shkencërisht, thekson historiani Wolfram Wette: "Qëllimi ishte të pushtohej Bashkimi Sovjetik, të reduktohej popullsia, të vidhej vendi në mënyrë që në një të ardhme, vendi të kolonizohej me gjermanë, për të ngritur një Perandori të madhe gjermane, nga Atlantiku deri në Uraltë".

Gjenocidi kundër hebregjeve evropiano-lindore,

vrasja masive e të burgosurve të luftës dhe civilëve ishin llogaritur shumë mirë. Nga elita ushtarake nuk erdhi kundërshtim. Pavarësisht nga propaganda e madhe, popullsia gjermane reagoi me ankth dhe tmerr. Frika se tani do të ndodhte një katastrofë ishte shumë e përhapur. Që edhe nga pala gjermane do të kishte miliona viktimë, nuk e parashikonte askush në atë kohë. Me ushtrinë gjermane, u bashkuan edhe forcat e armatosura të vendeve aleate: Italisë, Finlandës dhe Rumanisë. Bota nuk arrinte të kuptonte çfarë po ndodhte.

Njoftim i BBC: "Lajmet e BBC-së, New York. Gjermania, Italia, Finlanda dhe Rumania ndodhen prej 24 orësh në luftë me Rusinë. 5 milionë vetë marrin pjesë në të. Dhe ajo është duke u kthyer në luftën më të madhe që ka pasur ndonjëherë në histori. Midis Bukovinės dhe Detit të Zi kanë shpërthyer luftime të ashpra. Gjithçka është duke u zhvilluar aq shpejt, sa që kryeqytetet e botës kanë vështirësi të kuptojnë çfarë po ndodh". Në Britaninë e Madhe, kryeministri Winston S. Churchill iu drejtua me një fjalim në radio popullit. "Hitleri është monstër e së keqes. I pangopur në epshin e tij për gjak dhe plaçkitje. Sikur të mos i mjaftonte që vuri gjithë Evropën nën çizmen e tij, terrorizoi dhe mjeri, ai i kthehet tani Rusisë për të vazhduar masakrën dhe shkatërrimin".

Shtetet baltike, Bjellorusia dhe Ukraina u morën shpejt. Hitleri dhe gjeneralët e tij kanë bërë planet që me një "luftë rrufe" të marshonin deri në kryeqytetin sovjetik, por ata i kishin bërë llogaritë gabim. Pak muaj pas fillimit të sulmit, njësitë e ushtrisë bllokohen në dimër para Moskës - sipas vlerësimeve të sotme, ky ishte fillimi i humbjes përfundimtare më 1945. 3 milionë ushtarë gjermanë nuk u kthyen më në shtëpi. Wolfram Wette: "Rusia vetë pati dhjetëfishin e viktimave. Prej tyre 10 milionë ishin të Ushtrisë së Kuqe, pra ushtarë që luftuan. Më shumë se 3 milionë ishin të burgosur lufte që përfunduan në kampet gjermane. Po ashtu 3 milionë hebrenj rusë u vranë sistematikisht nga gjermanët. Rreth 6 milionë civilë sovjetikë ranë viktimë e politikës shfarosëse gjermane".

Dekada me radhë, përgjegjësia gjermane për luftën shkatërruese në Lindje nuk ka qenë temë e debateve publike. Kujtimet lidheshin kryesisht me vuajtjet e veta. Legjenda e "Wehrmachtit të pastër", jetoi gjatë duke ia kaluar përgjegjësinë për krimin organizatave nacional-socialiste, si për shembull SS. Empati për viktimat e panumërta nga pala sovjetike nuk ka pasur mes popullsisë gjermane. Vetëm studimet e historianëve kritikë, dhe më vonë edhe ekspozita shumë të diskutueshme dhanë mundësinë për të filluar një proces rishqyrtimi. (bota.al)



“SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO” BOTOHET EDHE NË TURQI

Përkthyesja turke e këtij romani, Ece Dillioğlu, ka shkruar një status të sajën në Facebook, ku shprehet me këto fjalë: “Një libër i mrekullueshëm i Dritëro Agollit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” u përkthye në turqisht. Unë si përkthyesja e librit, mund të them se këtë roman duhet ta lexojnë të gjithë, pasi çdo njeri e ka një personazh si Zyloja në jetën e tij

“Romani Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zylo”, i Dritëro Agollit, është një nga veprat më popullore në Shqipëri, por është edhe më i përkthyeri në shumë vende të botës. Këto ditë, kjo kryevepër e letërsisë shqipe, është botuar edhe në Turqi. Lajmin e ka bërë të ditur vajza e shkrimtarit, Elona Agolli, e cila shprehet e entuziazmuar se: “Sot, mora lajmin e bukur që Zylo do t’iu flasë turqisht 80 milionë banorëve të atij vendi, që im atë e njihje, e donte, e adhuronte, ndjehej si në shtëpinë e tij. Kur udhëtoja për në Stamboll më thoshte: Atje, buzë Bosforit, tek peshkatarët, atje do të doja të shkoja dhe unë. Sa do të gëzohej e lumturohej sot ai.

Do të fillonte të kujtonte udhëtimet e tij në Stamboll, Ankara në vitet ‘80; bisedat e zifafet me Azis Nesin; Do të mernte librin në dorë e do të qeshte me fjalët e bukura turke, qe aq shumë ua pëlqente


muzikalitetin e tyre. Sot u shëmbëlleva, u gëzova, u lumturova në atë pjesën e qenies sime ku është babi, pasi unë jam ai, pasi kjo është përjetësia. Ai dhe unë u gëzuan e lotuam shumë”, shkruan vajza e shkrimtarit, Elona Agolli, në rrjetin social në facebook.

Elona Agolli gjen rastin të rrëfej edhe kujtimet e të atit që lidhen me botimin e veprës. Ajo rikthen kujtimet e shkrimtarit të madh të shkruar 25 vjet më parë: “Kur botova romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” kam ndërë kënaqësi të vërtetë. Është i pari roman në Shqipëri që e bën qesharak socializmin dogmatik. Këtë gëzim ndjeva edhe kur u botua në Bullgari dhe mora letër nga kolegët bullgarë në vitin 1978 (në atë kohë ishte e ndaluar të kishe korrespondencë me vendet ish-socialiste apo revizioniste siç i quanin ne) dhe më vonë kur u botua në Francë nga shtëpia

botuese “Gallimard”, nga shtëpitë botuese më të mëdha në Evropë.”, kështu shkruante në një intervistë të 25 viteve më parë Dritëroi”, thotë Elona Agolli.

Ndërsa përkthyesja turke e këtij romani, Ece Dillioğlu, ka shkruar një status të sajën në Facebook, ku shprehet me këto fjalë: “Një libër i mrekullueshëm i Dritëro Agollit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” u përkthye në turqisht. Unë si përkthyesja e librit, mund të them se këtë roman duhet ta lexojnë të gjithë, pasi çdo njeri e ka një personazh si Zyloja në jetën e tij. E falënderoj edhe zonjën Elona Agolli për bashkëpunimin që ka bërë”, shkruan Ece Dillioğlu.

Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” i Dritëro Agollit, i botuar në vitin 1973, është një “kronikë” e karrierës së palavdishme të një zyrtari të periudhës së komunizmit; në të njëjtën kohë pasqyrë e



pozitës së mjerë të vartësit të tij, Demkës, një kalemxhi i stërvitur, por i pataentuar. Personazhet Zylo dhe Demka, janë shkurtime të emrave tradicionalë “Zylyftar” dhe “Demir”. Komizmi i figurës së Zylos buron nga kontradikta themelore e karakterit të tij: ai i jep vetes të tjera vlera nga ato që i takojnë, duke menduar se hierarkia shtetërore është edhe hierarki meritash. Shoku Zylo është një nga qindra e qindra nëpunësit e mesëm të një aparati shtetëror me shumë instrumente. Ai nuk është pa merita pune, diçka ka bërë, por këto merita në shoqëri kanë vlerë më të vogël sesa në mendjen e Zylos. Në të vërtetë Zylo Kamberi është një figurë tragjikomike. Veprimet e tij të bëjnë të qeshësh, po aq sa edhe të ndiesh

keqardhje. Zyloja nuk është një burokrat dukshëm prepotent, bujmadh, i zhurmshëm. Arroganca e tij është e heshtur. Prepotenca e tij është me zë të ulët. Veprimet e tij përherë priren nga qëllime të mbara, por çojnë në gabime trashanike. Sekret i suksesit : analiza e hollë dhe djallëzore e hipokrizisë së pushteteve burokratike nëpërmjet figurës së jashtëzakonshme të drejtorit Zylo. Historia e Zylos vlen për të gjithë vendet dhe për të gjitha kohërat, sukses i universalizmit që ka vete vepra. I pari që e ka përkthyer këtë libër ka qenë Kristian Gyt, ish-Drejtori i Arkivave dhe Kalorës Nderi i Francës. Më pas, libri është përkthyer në Gjermani, Itali, Greqi, Bullgari, Rusi, Maqedoni, etj.

Aliçka dhe Myftiu në një rrëfim për letërsinë shqipe në Paris

Shkrimtarët Ylljet Aliçka dhe Besa Myftiu do të jenë në një rrëfim mbi letërsinë shqipe në Paris. Ata do të jenë pjesë e dy takimeve letrare, që Biblioteka Universitare e Gjuhëve dhe Civilizimeve “Boulac”, në Paris, do të organizojë këtë fillim tetori, dedikuar posaçërisht letërsisë shqipe. Takimi i parë do të organizohet më 6 tetor 2018, me temë qendrore “Letërsia shqipe nga një gjuhë në tjetrën”, dhe gjatë tij do të trajtohen çështje të tilla, si: Cila është natyra e shkëmbimeve mes autorit dhe përkthyesit? Cilat janë vështirësitë dhe pengesat e përhapjes dhe eksportimit të letërsisë jashtë kufijve të Shqipërisë? Takimi i dytë do të organizohet më 9 tetor 2018, me temë “Brenda dhe jashtë”, dhe gjatë tij do të trajtohen çështje, si: Shkrimtarë nga Shqipëria dhe diaspora; Hijet e komunizmit në letërsinë shqipe etj.

SEMINARI XII NDËRKOMBËTAR I ALBANOLOGJISË

“Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë”

Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë ishte tema boshte e Seminarit XII Ndërkombëtar të Albanologjisë që i zhvilloi punimet të premtën në Universitetin e Tetovës. Prorektori për Arsim i Universitetit të Tetovës, prof. dr. Reshat Qahili tha se ky seminar i paraprind fillimit të vitit të ri akademik 2018/2019 dhe i njëjti organizohet në Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut, kryeheroi të kombit tonë.

Drejtori i Seminarit të Albanologjisë, Salajdin Saliu, para pjesëmarrësve tha se në këtë seminar, krahas temës qendrore, do të diskutohet edhe për tema të tjera nga gjuhësia, letërsia, historia, etnokultura apo sfera e medias. “Do të flitet për mundësinë e digitalizimit të trashëgimisë sonë kulturore, ashtu sikurse veprojnë kombet e qytetëruara, që kanë kujdes ndaj kujtesës. Do të flitet



për përplasjen ndërmjet botës së Gutenbergut dhe botës digjitale, si dhe për traumat që na përcjellin në këtë meskohë. Gjithashtu, në kuadër të seminarit të sivjetëm, e promovojmë veprën kapitale, siç është “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i profesorit të respektuar, të ndjerit Kolec Topalli, një mendje e bukur e botës kulturore shqiptare. Në kuadër të

seminarit e promovojmë edhe numrin më të ri të revistës “Albanologjia”, një nga shumë revista shkencore që mbajnë logon e Universitetit të Tetovës. Kjo revistë që sjell studime nga gjuhësia, letërsia, historia, etnokultura dhe mediat, është një kontribut yni modest për kulturën tonë”, nënvizoi Saliu.

Në kuadër të hapjes solemne

të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë u promovua “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i autorit tashmë të ndjerë akademik Kolec Topalli. Mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e kësaj vepre foli drejtori i Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë në Tiranë prof. Valter Memishaj. Kurse prof. Dr Anila Omari nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, deklaroi se “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” i profesor Koleci i nisi që në vitet e 70’ dhe rezultatet e para të kësaj pune panë dritën e botimit në të vetmen revistë shkencore të Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë “Studime Filologjike”, tha Omari.



Robotët do të kryejnë 52 për qind të punës deri më 2025

Në një studim të ri është thënë se robotët do të kryejnë më shumë se "gjysmën e detyrave aktuale në vendet e punës" deri më 2025. Në një raport të Forumit Ekonomik Botëror, të prezantuar më 17 shtator, vlerësohet se, 52 për qind e të gjitha detyrave, pothuajse dyfishi i normës aktuale do të përfundohen nga makinat. "Deri më 2025 më shumë se gjysma e detyrave të punës do të kryhen nga pajisjet, në krahasim me normën aktuale prej 29 për qind", ka thënë Organizata joqeveritare me bazë në Zvicër. Në raportin e titulluar, E Ardhmja e vendeve të Punës 2018, Organizata ka thënë se konsideron që robotët do të zëvendësojnë njerëzit në sektorin e menaxhimit të klientëve, kontabilitetit, postës dhe ata industrialë.

Në po të njëjtën kohë, në raport është thënë se do të ketë rritje të kërkesës për vendet e punës që kërkojnë "aftësi njerëzore", siç janë shitjet, marketingu, shërbimet ndaj konsumatorit, së bashku me ato që lidhen me shitjet online dhe rrjetet sociale. Sipas raportit, sfida kyçe do të jetë në fazën e trajnimit të punëtorëve, sidomos në fushën e "kreativitetit, mendimit kritik dhe vendosshmërisë". Në këto të gjetura Qeveritë këshillohen, që të përgatisin punëtorët e rrezikuar nga ato që janë konsideruar si "ndryshime të mëdha" në kualitetin dhe vazhdimësinë e vendeve të punës.

VW SHËNON REKORD, KA SHITUR MBI 7.3 MILIONË VETURA

Grupi Volkswagen la pas aferën Dieselgate, e cila i kushtoi shumë para, por jo edhe humbjen e konsumatorëve që blenë 7.302.500 automjete në periudhën janar-gusht në mbarë botën

Gjiganti gjerman për prodhimin e veturave, Volkswagen, i cili zotëron një duzinë markash automobilash dhe kamionësh, shënoi rritje të shitjeve prej 7.5% në tetë muajt e parë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Grupi Volkswagen la pas aferën Dieselgate, e cila i kushtoi shumë para, por jo edhe humbjen e konsumatorëve që blenë 7.302.500 automjete në periudhën janar-gusht në mbarë botën. Evropa mbetet tregu më i rëndësishëm dhe më i madh për VW, meqë 3.155.400 automjete u transportuan në kontinentin e vjetër në tetë muajt e parë, me një rritje të shitjeve prej pothuajse 10%.

Rreth 2.9 milionë makina ose 6.8% më shumë janë shitur në rajonin e Azisë dhe Paqësorit, nga të cilat vetëm 2.65 milionë janë



dërguar në Kinë. Në tregun e Amerikës së Veriut, të gjitha markat që veprojnë në kuadër të Grupit VW shitën 631,500 automjete dhe ky është i vetmi rajon i madh në botë që shënon një rënie të lehtë gjatë vitit të kaluar prej -0,2%. Nga ana tjetër, në Amerikën e Jugut janë shitur 387,400 automjete ose 13,3% më shumë se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sikurse pritej, veturat VW ishte marka më e shitur brenda grupit. Në periudhën janar-gusht 2018, gjithsej 4,137,900 makina me emblemën e kësaj marke gjermane u shitën në mbarë botën, me një rritje prej 6,2%. Pason Audi, e cila në tetë muajt e parë të këtij viti ka shitur

1.268.600 makina me një rritje prej 5,5%. Shkoda shiti 844.200 automjete ose 11,4% më shumë dhe Seat 383.900 makina ose 21,9% më shumë.

Rritje të shitjes shënoi edhe Porsche me 6,8%, ku në tetë muajt e parë të këtij viti janë shitur 176.400 automobila të këtij brendi. Gushti ishte veçanërisht i suksesshëm për grupin VW, pasi u shitën 875,300 automjete, nga të cilat 513,300 ishin markë mëmë. Mbetet për t'u parë nëse deri në fund të vitit, VW Group do të ketë sukses në tejkalimin e shitjes së Grupit Renault-Nissan, i cili në 2017 e fitoi titullin e prodhuesit më të madh të makinave në botë.

Themeluesit e Instagramit largohen nga kompania

Bashkëthemeluesit e aplikacionit për shpërndarje të fotografive, Instagram, Kevin Systrom dhe Mike Krieger do të largohen nga kompania. Systrom, deri tani shef ekzekutiv i aplikacionit ka thënë se ata do të largohen për të "zbuluar kreativitetin tonë". Instagram, aplikacion që është blerë nga Facebook më 2012 në vlerë të 1 miliard dollarëve, tani ka më shumë se 1 miliardë përdorues. Njoftimi për largimin e këtyre dy personave ka ardhur në kohën e raportimeve për marrëdhënie të tensionuara në mes të tyre dhe udhëheqësisë së Facebookut. "Tani



jemi gati për kapitullin e ri", ka thënë Systrom në një deklaratë. "Ndërtimi i gjërave të reja, nënkupton që ne duhet të largohemi, të

kuptojmë se çfarë na inspiron dhe të përkohet me atë që ka nevojë bota, kjo është ajo që planifikojmë të bëjmë". Ndërkohë, themeluesi i kompanisë, Facebook, Mark Zuckerberg ka thënë në një deklaratë se Instagrami ka reflektuar mënyrën se si themeluesit e këtij aplikacioni kanë "kombinuar talente kreative". "Unë kam mësuar shumë duke punuar me ata në gjashtë vjetët e fundit dhe kam shijuar. Mezi po pres të shoh se çfarë do të krijojnë tani", është shprehur ai. Systrom dhe Krieger, janë në të 30-at e tyre, derisa studiojnë në Universitetin Stanford.

Automjetet autonome mund të shndërrohen në armë

Muajve të fundit kanë ndodhur disa aksidente në të cilat morën pjesë veturat autonome, ku pati edhe raste me epilog fatal dhe njëra nga gjërat me rëndësi ka të bëjë me sigurinë. Drejtori i kompanisë teknologjike BlackBerry, John Chen paralajmëron për rrezikun shtesë në lidhje me veturat autonome, për shkak të mundësisë së hakimit të tyre, gjë e cila mund t'i shndërrojë ato në armë në duart e kriminelëve. Edhe pse BlackBerry punon në zhvillimin e teknologjisë së saj autonome në vozitje në bashkëpunim me gjigantin kinez të internetit Baidu, kompania tërheq vërejtjen mbi rreziqet që bart kjo teknologji.

Chen thotë se këto makina kanë në shumë linja të kodit

kompjuterik se sa aeroplanët standard luftarakë, gjë e cila iu mundëson hackerëve hapësirë të madhe për keqpërdorim. "Automobili lehtë mund të infektohet me viruse dhe të transformohet tërësisht në armë. Nëse një hacker mund ta marrë atë, mund të imagjinojë se çfarë mund të bëjë. Unë mund ta bëjë makinën 90% të sigurt nga virusi, por sapo të arrijë në rrugë, këto kushte duhet kontrolluar rregullisht", tha Chen. Chen thekson se ka ende shumë sfida përpara se makinat autonome të bëhen një fenomen masiv në rrugë.

"Vetë-menaxhimi është ende në mënyrë të konsiderueshme e varur nga gabimi njerëzor dhe kontrolli i sigurisë. Rregullat dhe kërkesat e sigurisë teknologjike



duhet të krijohen para se të lejohen këto automjete të dalin në rrugë", thotë drejtori i BlackBerry.

Teknologjia autonome është gjithashtu një sfidë e madhe për kompanitë e sigurimeve dhe

ligjvënësit, të cilët duhet të vendosin se kush do të jetë përgjegjës në rast aksidenti.

Mendo BESIM.

 Sigurime MOTORRIKE

 Sigurime PASURIE

 Sigurime JETË

Mendo


UNIQA

+389 2 3288 800
www.uniqa.mk

SIGURIME
JETË dhe JO-JETË



DASHI 21. mars - 20. prill

Jupiteri do mundo het ta mbroje jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite, por kjo do jete mjaft e vështirë. Kokëfortësia dhe padurimi juaj do jene pikat me te dobëta te cilat mund te shkatërrojnë gjithçka. Beqaret do e pëlqejnë jashtë mase një person qe do takojnë, por ai do tregohen indiferent. Mos u dorëzoni lehte. Sektori i financave do ketë përmirësime te ndjeshme.



DEMI 21. prill - 21. maj

Për shkak te një ambienti shume te trazuar ne jetën tuaj ne çift, dita nuk do jete aspak pozitive. Përkundrazi debatet do duken te pafundme. Duhet me patjetër te ndërtoni një marrëdhënie barazie edhe mosmarrëveshjet te marrin fund. Beqaret do kenë vetëm flirtime, asgjë me tepër. Ne planin financiar situata do jete e paqëndrueshme prandaj mos kryeni shpenzime te tejskajshme.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Duhet te komunikoni me tepër me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe t'i shprehni me tepër ato qe ndjeni. Vetëm ne këtë mënyrë lidhje juaj do ece si duhet dhe nuk do ketë probleme. Beqaret me gjase do hedhin hapat e para drejt një lidhjeje te qëndrueshme. Edhe për planin financiar dita do jete pozitive. Mund te ketë edhe përmirësime te buxhetit.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dite shume e qete dhe pa problemin me te vogël kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni mire pranë partnerit dhe do e mbronni lidhjen nga çdo faktor i jashtëm. Beqaret duhet te kërkojnë personin qe ju përshtatet me mire ne çdo sektor, jo dike me lart apo me poste se ta. Ne planin financiar do e rigjeni ekuilibrin dhe do mund te shpenzoni disa para me tepër.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kushtojni vëmendjen e duhur sot atij qe keni ne krah sepe po e late pas dore dikush mund t'ua "rërmbejë" menjëherë. Është një person qe po e vështron nga larg marrëdhënien tuaj dhe mezi pret qe ajo te prishet. Beqaret do kenë disa takime gjate kësaj dite dhe do kenë mundësi te bëjnë zgjedhjen e duhur. Për financat do jete dite me fat. Buxheti do përmirësohet ndjeshëm.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dita e sotme do jete paska e ndërlikuar sot. Do debatoni ashpër me personin qe keni ne krah dhe asnjeri nuk do hape rruge. Kujdes, kështu si e keni nisur nuk do shkoni shume gjate bashke. Beqaret do ndihen mire ashtu si janë dhe nuk do e ndiejnë aspak nevojën e krijimit te nje lidhjeje. Ne planin financiar nuk është koha te ndërmerreni reziqe te mëdha.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Tregohuni sa me te sinqerte me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe mos i mbani asnjë te fshehte atij. Ne këtë mënyrë do ndiheni me pranë njeri-tjetrit dhe atmosfera do ngrohet se tepërmi. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim te dashurisë, por pa fat. Ne planin financiar duhet te hiqni dore nga disa shpenzime nëse doni qe situata mos jete problematike.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Do keni disa vështirësi sot ne jetën tuaj ne çift, por me mirëkuptim dhe tolerance mund te zgjidhni gjithçka. Bashkëpunoni me tepër dhe flisni për çdo gjë. Beqaret do kenë një nga takimet me mbresëlënëse dhe do kenë mundësi reale për te filluar një lidhje te qëndrueshme. Ne planin financiar duhet te tregoheni vigjilente dhe te kujdesshëm me shpenzimet.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do bashkëpunoni me se miri me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe do e përforconi lidhjen ne çift. Ne disa momente atmosfera do ngrohet mjaft dhe emocionet do jene te fuqishme. Beqaret nuk do jene shume kërkues dhe për këtë fakt do gjejnë shume persona te përshtatshëm. Prisi pak para se te filloni një lidhje. Për financat do jete dite goxha e vështirë.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Venusi do e mbroje jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Do i sqaroni mosmarrëveshjet qe keni pasur dhe do e shihni me optimizim te ardhmen. Beqaret nga ana tjetër do i marrin gjerat si t'iu vijjnë dhe nuk do kërkojnë asgjë me ngulm. Ne planin financiar nuk do kenë vështirësi te mëdha, por duhet me patjetër te bëni një riorganizim tërësor te situatës.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Sot do futeni ne një periudhe shume te favorshme për jetën tuaj ne çift. Do ndiheni me te sigurte se personi qe keni ne krah është i duhuri dhe do hidhni hapa me tej. Beqaret do kenë një dite te zakonshme dhe pa te reja. Gjithsesi fale pranisë se miqve ata nuk do e ndiejnë nevojën e dikujt ne krah. Para se te kryeni shpenzime duhet te mateni mire. Financat nuk do jene shume te qëndrueshme.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ka mundësi te bëni edhe ndonjë çmenduri te vogël sot ne jetën tuaj ne çift, vetëm e vetëm qe lidhja juaj te jete me emocionuese. Beqaret nga ana tjetër do pëlqejnë me shume sesa duhet një person i cili ka tashmëje angazhim. Mos hidhni hapa te nxituar qe te mos lëndoheni. Situata financiare do jete komplekse. Me mire mos kryeni investime te tejskajshme sot.

Mensur Mamuti	KËSULË MENDAFSHI E NUSEVE ARBËRESHE	PËRJETIM I KENDSHEM	VEPËR LETRARE E HEROIT NË FOTO	EMRI I VEPRIMTARIT, SHKRIMTARIT DHE MUZIKANTIT NË FOTO	HISTORIANE DHE AUTORE AMERIKANE				
PLUA E NXHETË E MENGJESIT						NE KETE DATE			
FESTË ISLAME (LINDJA E MUHAMEDIT)									
M						1 TETOR 1943 18 JANAR 1982			
SUNDUESI I QIELLIT DHE TOKES TE GREKET									
AKTORI KROAT, NALIS						Q			
KOHA	ERË E VRULLSHME ME SHI TE MADH								
	PËRCAKTON (HUAJ)					NGJYRË KOMPLEMENTARE (NJËRA NGA 4 NGJYRAT CMYK)			
NJË GJINI E ZËRIT (MUZ.)				500 ROMAK					
LLOJ MOLLE						PJATA			
V									
POLITIKANI PAKISTANEZ, ALI BUT						PERUXHA			
IMPULSI	AZOTI			AUSTRIA		SHTROJË DHOMË (SHQ.)			
	PESHK I UJËRAVE TE EMBLA, LLOSKË (SH.)			RUMANIA					
BASHKËVEPRIM						LLOJ EMBËLSIRE			
NJË PASTHIRRMË				KANCELARIA GJERMANE, MERKEL		FLIE QË LIDH TRURIN ME ORGANET E TRUPIT			
				QYTET NË KOSOVË					
MODELJA ZVICERANE, BENATIA						FAM. EMËR I NJOHUR (SH. PASHQ.)			
GRUPE NJERËZISH, BASHKËSITË	NJË SURE E KURANIT					GJENDJA E LIRË E MOTORIT			
	PASTHIRRMË KËNAQËSIE								
T				ISH LIDERI I BRSSË, VLLADIMIR ILIÇ		VËNDOJ			
QYTET NË GJERMANI						TEMPERATURA			
OLIVER TUISTI				MBIEMRI I VEPRIMTARIT, SHKRIMTARIT DHE MUZIKANTIT NË FOTO		LLAMBDA			

ZGJIDHJET: KAFJA, MEVLUD, ZEUSI, ANTUN, TUEFA, DUR, D, VERORE, FAJAZ, I, N, A, Q, NDERVEPRIM, ORE, ANGELA, NABILLA, VIG, NISA, NAME, TOGET, LENIN, HANOVERI, T, OT, GËRVALLA.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

9			3	1			5	4			2	3		6
	7			5			9		2		7			1
		5	7		9	4				5				7
5		4				6	8							2
	3						2			9		4	6	
2		6			3		9				8			3
		2	1		8	5		9						
	6			3			4	7	8			9		3
8			6		2		7					7	6	1

Shumë i lehtë: 948321765, 671854293, 325769481, 514293678, 739586124, 286417359, 492178536, 167935842, 853642917. Mesatar: 471923568, 628754193, 395681742, 154237986, 839546271, 267819354, 9134465827, 786192435, 542378619.

Për më shumë se gjysmën e britanikëve, "pije+puthje" përkthehet në seks



Më shumë se 50% e britanikëve nuk besojnë se është e pranueshme që një person të refuzojë marrëdhënien seksuale nëse ai është zhveshur bashkë me partnerin e tij të mundshëm, sipas hulumtimit të kryer nga një organizatë bamirëse për shëndetin seksual.

Shoqata e Planifikimit Familjar (FPA) njoftoi se studimi i saj theksoi "sjelljet thellësisht shqetësuese", pasi shumë të anketuar argumentuan se nuk është e drejtë të mohohet seksi nëse kanë blerë pije alkoolike ose e kanë puthur tashmë personin tjetër. "Është me të vërtetë shqetësuese që njerëzit e të gjitha moshave besojnë se nuk është e drejtë të mos ofrojnë konsensusin e tyre në një varg situatash", tha Natika Halili, kreu i FPA.

"Gjithmonë është mirë të thuhet jo për marrëdhënien seksuale në të cilën personi nuk ndihet rehat, pa marrë parasysh se çfarë situatë".

Sondazhi përfshiu 2000 persona dhe u botua në kuadër të Javës së Shëndetit Seksual në Britani. Bazuar në anketën e kryer, të anketuarit në moshë më të re ishin ata që besonin se ka shumë të ngjarë që ishte e padrejtë që përfundimisht të refuzonin marrëdhëniet seksuale në rrethana të caktuara. 60% e adoleshentëve të moshës 14-17 vjeç dhe pothuajse ¾ e njerëzve të moshës 25-34 vjeç raportojnë se është tepër vonë për të thënë jo, në krahasim me

30% të njerëzve të moshës 45-54 vjeç. Gjetjet "shqetësuese" tregojnë se sa punë duhet bërë për të edukuar qytetarët për kufijtë e konsensusit, tha Katie Russell.

"Është e rëndësishme që ne të fillojmë të edukojmë fëmijët që në moshë të hershme konsensusit dhe autonomisë fizike nëse duam të kemi një mundësi për të reduktuar dhe përfundimisht t'i japim fund shkallës së lartë të dhunës seksuale në këtë vend", shtoi Russell. Një në pesë gra në Angli dhe Uells kanë qenë viktime të sulmit seksual që nga moshën 16 vjeçare, sipas shifrave të qeverisë britanike.

Dimrin e kaluar, nga gripi vdiqën 80.000 njerëz



Rreth 80.000 persona vlerësohet të kenë vdekur si pasojë e grupit dhe komplikimeve të tij përgjatë dimrit të vitit të kaluar në SHBA, shifër kjo më e larta në 4 dekadat e fundit. Drejtori

për Qendrën për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, Dr. Robert Redfield, bëri të ditur shifrën alarmante gjatë një interviste për "The Associated Press". Megjithatë ekspertët e dinin

se ai i kaluari ishte një sezon tepër i keq, shumë e gjejnë numrin e vdekjeve surprizues. Vitet e mëparshme, vdekjet e lidhura me gripin varionin nga 12.000 në 56.000. Shumica e vdekjeve erdhën nga radhët e fëmijëve dhe të moshuarve, me pikun që arriti në muajt Shkurt dhe Mars. Ajo që e bëri edhe më të keqe situatën ishte fakti se vaksinat e gripit nuk dhanë efektet e pritshme. Të dhënat e vdekjeve nga gripi përgjatë dimrit të kaluar raportohet se kanë qenë më të larta se ato të të gjithë viteve që prej vitit 1976-1977. Si vitet me gripin më vdekjeprurës në histori ndërkohë vlerësohet të jetë pandemia që nisi në vitin 1918 dhe zgjati dy vite duke vrarë më shumë se 500.000 amerikanë.

Zemërgjerësia është ngjitëse

Zemërgjerësia është ngjitëse. Ajo është një nga karakteristikat që na dallon dhe njëkohësisht çelësi i suksesit të specieve sonë. Bëhet fjalë për aftësinë e bashkëpunimit në mënyrë fleksibël, sipas kontekstit dhe kërkesave. Madje humanët e bëjnë edhe kur nuk fitojnë asgjë në këmbim dhe këtu mjafton të kujtojmë kur dhurojmë gjak ose në kontributet për bamirësi, ato të vërtetat.

Dhe ndoshta më shumë se faktor i trashëguar, është një sjellje që na ndikon drejtpërdrejt, e cila shpërndahet si një reaksion zinxhir brenda grupit në familje, punë, shoqëri etj. Këto janë rezultatet e studimeve mbi këtë karakteristike kaq njerëzore, por kaq të vështirë dhe të komplikuar për t'u shpjeguar. Kërkimet e disa universiteteve botërore janë përqendruar prej kohësh në këtë argument, konkluzionet e të cilit e kanë publikuar në revistën Current Biology.

Ekspertët kanë vrojtuar edhe sjelljet



e tribusë Hazda në Tanzani, e cila është një ndër popullsitë e pakta në botë me stil dhe zakone që i trashëgojnë në mënyrë fanatike që nga të parët e njerëzimit.

Dhe rezultoi se njeriu ka tendencën të bëhet zemërgjerë, të bashkëpunojë për të mirën edhe të të tjerëve, në ato ra-

ste kur është brenda grupit të tij. Dhe sjellja pozitive transmetohet edhe kur kemi një grup të përbërë nga persona egoistë, pasi mjafton që njëri të tregojë bashkëpunim, dashamirësi dhe kujdes për tjetrin, që kjo të ndikojë ngadalë tek kushdo duke përmirësuar marrëdhënien njerëzore.

331 BC - Leka i madh mund Darin III të Persisë në betejën e Guagamelës.

1189 - Gerard de Ridefort, mjeshtri i madh i Kalorësve Templar që nga viti 1184, vritet në Rrethimin e Akrit.

1653 - Parlamenti rus pranon aneksimin e Ukrainës.

1768 - Trupat angleze nën Gjeneral Gauge zbarkojnë në Boston.

1787 - Rusët nën komandën e Suvorov mundin turqit në Kinburn.

1795 - Franca pushton Belgjikën.

1867 - Publikolet "Kapitali" i Karl Marksit.

1891 - Në Kaliforni hapet Universiteti Stanford.

1898 - Car Nikolla II dëbon hebrejtë nga qytetet e mëdha të Rusisë.

1936 - Generalissimo Francisco Franco themelon shtetin e Spanjës.

1943 - Gjermanët sulmojnë hebrejtë në Danimarkë.

1960 - Nigeria fiton pavarësinë nga Britania.

1977 - Pensionohet futbollisti i madh brazilian Pele me 1,281 gola të shënuar në 1,363 ndeshje të luajtura.

1988 - Mihail Gorvaçov zgjidhet kryetar i Bashkimit Sovjetik.

1990 - Serbet në Kroaci shpallin autonomi.

KALENDARI HISTORIK 1 TETOR



ÇFARË ËSHTË ABLUTOFOBIA?

Ablutofobia është frika e vazhdueshme e larjes, pastrimit dhe dushit. Kjo frikë prek më shumë fëmijët dhe femrat se sa meshkujt. Tek fëmijët mund të zhduket nëse mësohen se dushi apo uji nuk është diçka e rrezikshme. Ablutofobia është më e zakonshme në kombet evropiane. Shkencëtarët thonë se në shekullin e 16, pothuajse të gjithë njerëzit anglezë, francezë dhe vende të tjera evropiane kishin simptoma të ablutofobisë. Mbretëresha e Anglisë, Elizabeta e parë njihet si një nga më të "pastër" në Europë në atë periudhë pasi lahej një herë në muaj. Në atë kohë, konsiderohej si njeri që lahej shpesh dhe kjo gjë e bënte të pashëndetshme. Por, kjo frikë ka edhe pasojë dramatike për jetën. Para disa vitesh, një adoleshent britanik vdiq nga përdorimi i tepruar i deodorantit duke shmangur dushin si pasojë e ablutofobisë. Thithja e sasisë së lartë të gazit që gjendet në deodorant i shkaktoi vdekjen.

PACIENTIA DHE PSIKOLOGU

Pacientja : Doktor, jam 15 vjeçe dhe shtatzënë, si t'u them prindërve? Psikologu: Hap gojën e thuaj, përdërisa di të hapësh këmbët, di të hapësh dhe gojën...



Nuk ka rëndësi si ndihesh sot, ngrihu, vishu dhe shfaqu...!

(Paulo Coelho)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS